

# Kokomani & Lezho, letra e rrallë e dy gazetarëve që tronditi diktaturën komuniste

NGA SKIFTER KËLLIÇI

Arif Gjyli, përshtatësi i parë i Eposit të Kreshnikëve

NGA XHAHID BUSHATI

Ngjarja e rrallë, një pako me florinj në postën e Tiranës

NGA FREDERIK STAMATI

► FAQE 13-21



# [SHQIPTARJA.COM]

ÇMIMI 3000 LIRE VITI IX - NR. 116 (2639) | E DIEL, 19-05-2019 | www.shqiptarja.com

## ZGJEDHJET VENDORE

# VAZHDON "DUELI", RAMA E BASHA NUK TERHIQEN

Kryeministri nga Tirana: Nuk iki nga detyra. Zgjedhjet do të zhvillohen në 30 qershor, kush i pengon nuk hyn në SHBA dhe vendet e BE. Kreu i PD nga Londra: Qeveria tranzitore e largimi i Ramës zgjidhin krizën


► FAQE 2-3

## DOKUMENTET

### PD tenton të kapë Kushtetuesen, por Çlirim Gjata u tërhoq nga frika e Vettingut

Zbulohet letra, Gjata (nga PD) i shkruan KED-së: U tërhoqa sepse ju jeni institucioni i kapur

NGA ADRIATIK DOÇI  
► FAQE 7



## HETIMET

### Shit-blerja e votave Vangjush Dako pyetet për 5 orë te Krimet e Rënda

Kryebashkiaku u jep përgjigje 20 pyetjeve të dy prokurorëve. Bisedat që nxorën emrin e Dakos dhe njohja me Avdyllajt

NGA ELTON QYNO  
► FAQE 5



## UDHEZIMET E MINISTRISË

### FEMIJET, SI VEPROHET KUR KALON AFATI 60-DITOR I REGJISTRIMIT

Procedura e posaçme për fëmijët që lindin jashtë territorit të vendit  
► FAQE 9



### JA SIMPTOMAT E VARESISE NGA DROGA E ALKOOLI

Enkelana Lekli, psikologe klinike sqaron se cilat janë çrregullimet psikologjike që shkaktohen nga përdorimi substancave narkotike

► FAQE 11

## VENDIMI I GJYKATËS

### Prangoset në sallën e gjyqit, militani i PD, shpërndante drogë

Lavdosha Demaj u lirua në Elbasan, por Apeli në Durrës vendosi ta rikthejë në qeli sërisht

► FAQE 8

ELTON QYNO

## ANALIZA

### BATAKÇINJTË FANATIKË TË PUSHTETEVE

BAJRAM PEÇI  
► FAQE 22

## DOSIER

Një pllakë përkujtimore për Parlamentin e parë shqiptar

NGA QERIM VRIONI  
► FAQE 21



# Rama: Kush pengon zgjedhjet nuk hyn më në SHBA dhe vendet e BE

**Kryeministri në takim me 61 kandidatët për zgjedhjet lokale: Nuk iki nga detyra, data e zgjedhjeve nuk ndryshon**

Gjatë një takimi në Pallatin e Kongreseve me kandidatët socialistë për kryebashkiakë, kryeministri paralajmëroi se kushdo që tenton të pengojë procesin zgjedhor dhe ta çenjë atë, përveç burgut, do t'i ndalohej përjetësisht hyrja në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe në vendet e Bashkimit Evropian. Rama foli në emër të dy ambasadave më të mëdha në vend, duke thënë se kush prish zgjedhjet, do ju mohohet hyrja në Amerikë dhe vendet e Unionit Evropian. Mesazhi i kryeministrit ishte i qartë për jo vetëm për Sali Berishën, Lulzim Bashën dhe Monika Kryemadhin, por edhe për njerëzit dhe komisionerët e tyre, të cilët mund të tentojnë prishjen e zgjedhjeve të 30 qershorit. “Në asnjë cep bashkie nuk duhet të vë në dyshim a do bëhen apo jo zgjedhje. Kush i afrohet një qendre votimi, djeg veten, jo zgjedhjet. Sa më shumë të informohen për Kodin Penal, dhe nuk ja vlen të digjesh për politikën më kriminale të mundshme që të nxit të shkosh me këmbët e tua në burg, të dënuar për krime zgjedhore që u hiqet e drejta për hyrjen në SHBA dhe BE”. Nuk dua t’ja shoh asnjë shqiptari këtë qeder, dhe të mbetet tërë jetën pa hyrë në BE dhe SHBA dhe shkoi e vajti pas udhëheqjes që kërkon ta bëjë përsësh Shqipërinë. Do faktojmë me audio, me video me foto, çdo shkelje. Ne do të bëjmë një fushatë, në radhë të parë për demokracinë, për përgjegjësinë e çdo kujt që t’u rrijë larg të mbyturve që duan të mbytin Shqipërinë”, tha Rama.

## RAMA: NUK IKI NGA DETYRA!

Kryeministri Edi Rama përsëriti disa herë me vendosmëri se nuk do të heqë dorë nga posti i tij, për sa kohë ka marrë besimin e qytetarëve për një mandat të plotë, të cilin ai e quajti një luftë për të ndryshuar vendin, të cilën nuk do ta lë përgjysmë. “Nuk e mundim dot me zgjedhje, ndaj Rama ik. O burra të shpëtojme vatanin, se kemi me vete edhe filxhanin. Të iki Rama që të qetësohen të marrosurit për pushtet. Por është hap pas, nga nisi rruga jonë e vështirë. Unë nuk i iki kësaj detyre se në çdo drejtim kam nisur një luftë që nuk ka shans ta lë në mes, ku përbal-



## Rama:

### Pas 30 qershorit demokratët do jenë me thirrjet ‘Luli ik’

Kryeministri Edi Rama edhe një herë u shpreh i vendosur për dialog me liderin demokrat Lulzim Basha. “As kundërshtari nuk zgjidhet, as dialogu nuk duhet të ndalet. Jam i gatshëm të ulem me Bashën. Kushte nuk kam, jam i gatshëm t’i ofrojmë gjithçka, por Kushtetutën e kemi të njëjtë, dhe na takon ta respektojmë, ne më të drejtën për të hyrë në zgjedhje më 30 qershor, Luli për të mos hyrë në zgjedhje. (nuk do ja sugjeroja) (Këta na kanë rënë për kundërshtarë, që kanë humbur një pjesë të konsiderueshme të vetëkontrollit”, tha Rama. Sipas kryeministrit pas 30 qershorit do të jenë vetë demokratët që do të kërkojnë largimin e Lulzim Bashës, kur të kuptojnë pasojat politike të mos marrjes pjesë në zgjedhje. “Pas 30 qershorit do ketë thirrje ‘Luli ik’, kur të kuptojnë se çfarë marrëzie vetëvrasëse është për një grupim politik për të mos hyrë në zgjedhje”, tha kreu i qeverisë.

lem me probleme dhe ku nuk i gëzojmë dot një arritje reale, se buuum ballafaqohem me një problem real. Një luftë ku një herë marr frymë i lehtësuar kur zgjidh hallin e një njeriu të zakonshëm, herën tjetër mezi mbushem me frymë kur dikujt i është cenuar e drejta”, tha Rama.

## NUK NDRYSHON DATA E ZGJEDHJEVE

Kryeministri Edi Rama u shpreh i vendosur për të vijuar para me përgatitjet që 30 qershori t’i gjejë gati të gjithë kandidatët për kryebashkiakë të Partisë Socialiste. Kryeministri nuk shprehu asnjë lëkundje nga 30 qershori, duke

## Rama

“Sa më shumë të informohen për Kodin Penal, dhe nuk ja vlen të digjesh për politikën më kriminale të mundshme që të nxit të shkosh me këmbët e tua në burg, të dënuar për krime zgjedhore që u hiqet e drejta për hyrjen në SHBA dhe BE”.



## Nuk largohet

“Unë nuk i iki kësaj detyre se në çdo drejtim kam nisur një luftë që nuk ka shans ta lë në mes, ku përballem me probleme dhe ku nuk i gëzojmë dot një arritje reale, se buuum ballafaqohem me një problem real”.



thënë se nuk mund të dalë në shkelje të Kushtetutës. Rama ju drejtua kandidatëve, disa prej të cilëve kryebashkiakë aktual të konfirmuar për një garë të dytë elektorale, të bëjnë fushatë sikur përball tyre të kishin kundërshtarë. “Zgjedhjet do të mbahen më 30 qershor. 30 qershori nuk është një datë si gjithë të tjerat, por datë e përcaktuar sipas kushtetutës për të dëgjuar popullin sovran për vlerësimin e ofertave elektorale në 61 bashkitë e vendit. Oferta jonë është e plotë, 61 kandidatë dhe kandidatë e 61 lista për këshilltarë që do të çelin më 31 maj rrugëtimin drejt 31 qershorit. Në vend të një humbje mender ku me siguri mund t’i fitonin disa bashki, kundërshtarët zgjedhjen qederin për Shqipërinë, që do t’u mbetet bashkë me turpin në derë. Për shkak të ikjes së tyre nga rruga kushtetuese e zgjedhjeve dhe frikës së tyre për ballafaqimin me ne, në një pjesë të bashkive do ketë vetëm një kandidatë por do ketë fushatë intensive si asnjëherë më parë duke nisur nga kontaktet me njerëzit. Do shpenzojmë të gjitha energjitë tona kur do kemi kandidatë përballë. Edhe në ato bashki objektivi jonë është jo thjesht të fitojmë ato bashki portë realizojmë numrin më të madh të kontakteve njerëzore”, tha Rama.



## SHEREFEDIN SHEHU

### Ish-deputeti godet Bashën: Kursejini sharjet, çfarë nuk the për LSI-në

Ish-deputeti dhe kandidat i PD-së për kryebashkiak në Dibër, Sherefedin Shehu kërkon nga demokratët që të mos nxitojnë për të sulmuar Bindjen Demokratike. Ai u kujton të gjithëve atë që ka ndodhur më parë me partitë e tjera të dala nga PD-ja dhe që më pas u bënë pjesë e saj. Mes rreshtave ai kujton edhe rastin e LSI-së dhe fjalët e Bashës për partinë e drejtuar nga Monika Kryemadhi, por që më pas bënë koalicion. “Tani kemi aleat edhe LSI-në për të cilën lideri ynë ka thënë shumë gjëra si: ‘shushunja’, ‘kurrë koalicion apo pazar me LSI-në’, ‘vota për LSI -në, vota në det dhe në gjol’, ‘parti tipike klienteliste, që i bënte fresk (Ramës) nga mëngjesi deri



në darkë”, “sapo mbyllte pazarin me Ramën dhe merrte thelën e tepsisë, dridhe Like”, “ne nuk do të qeverisim me LSI-në, mos bëni gabimin fatal, përndryshe do të mbeten si Baftjarë në hauret e Republikës së Vjetër”, etj. Prandaj të mos nxitojmë por të durojmë sepse është më mirë që edhe “Bindja” një ditë të bëhet pjesë e PD-së apo koalicionit të saj. Eksperiencia tregon se lufta kundër “Bindjes” është luftë brenda llojit. Le të përpiqemi të gjejmë urat e bashkimit se vetëm bashkimi ka sjellë fitore për PD-në”, shkruan Shehu. Sherefedin Shehu vlerëson partinë Bindja Demokratike si produkt i mungesës së demokracisë dhe dobësisë së lidhshimit në PD. “O demokratë! Mos u bëni viktimë të udhëheqësve pa princip! “Bindja Demokratike” mund t’ju krijojë dilema për momentin e krijimit por jo për atë që ajo përfaqëson. Ajo është produkt i mungesës së demokracisë dhe dobësisë së lidhshimit në PD. Aty janë demokratë me kontribute dhe vlera për PD-në dhe demokracinë shqiptare. Prandaj kursejini insinuatat, sharjet dhe ofendimet. Historia e PD-së është histori e ndarjes dhe bashkimit. Kujtoni se çfarë nuk kemi thënë për Partinë Aleanca Demokratike dhe ajo u bë aleatja e fitores në 2005 dhe lidhshipi i saj ishte ose edhe është pjesë e lidhshimit të PD-së. Të njëjtën gjë bëjmë edhe me Partinë Demokratike të Re dhe lidhshipi i saj tani dominon lidhshipin e PD-së. Por edhe aleatët tanë më luajalë, Demokristianët dhe LZHK-istët, kanë qenë dikur pjesë e lidhshimit të PD-së dhe na kanë dalë disa herë edhe kundër. Kështu edhe PDIU që na ka marrë edhe lidera dhe vota. Megjithatë këto janë lëpirjet më të vogla të pështymës tone”, shkruan ai.





## ZGJEDHJET / PD-LSI SULM PARTISË BINDJA DEMOKRATIKE

## PD-LSI: Bindja Demokratike e paligjshme, regjistrim fals

Sekretari për çështjet zgjedhore në Partinë Demokratike, Ivi Kaso në një deklaratë për mediat ka hedhur akuza mbi kryeministrin, Edi Rama duke thënë se po kthen votimin monist duke urdhëruar falsifikimin e procesit zgjedhor të 30 qershorit me anë të partisë Bindja Demokratike. Sipas Kasos, Kuvendi ka lëshuar vërtetim falso sikur partia Bindja Demokratike përfaqësohet prej 6 muajsh në Kuvend, por përfaqësuesi Andi Përmeti ka më pak se 1 muaj që ka marrë mandatin. Ndërkohë Kaso ka thënë se PD ka paditur Sekretarin e Përgjithshëm të Kuvendit, Genc Gjonçaj, me pretendimin se ka

shkelur detyrën. "Është zbulimi i këtyre dokumenteve dhe shumë të tjerëve që kanë shqetësuar Edi Ramën dhe patericat e tij nga paraqitja e anëtarëve të opozitës në KZAZ. Anëtarët tanë do të dokumentojnë në çdo Komision Zonal manipulimin e dokumentacionit apo tentativat për regjistrimin e kandidatëve në kundërshtim me ligjin", tha ai. Nënkryetari i LSI-së Petrit Vasili në një komunikim për mediat ka



## DENONCIMI

Sekretari për çështjet zgjedhore në Partinë Demokratike, Ivi Kaso tha dje se Kuvendi ka lëshuar vërtetim falso sikur partia Bindja Demokratike përfaqësohet prej 6 muajsh në Kuvend, por përfaqësuesi Andi Përmeti ka më pak se 1 muaj që ka marrë mandatin.

reaguar në lidhje me denoncimin e bërë nga PD ku thuhet se Bindja Demokratike është regjistruar në mënyrë të paligjshme. Vasili tha se deputeti Andi Përmeti ka vetëm 4 javë në Kuvend ndërsa është përdorur për të përfaqësuar Bindjen Demokratike sikur të kishte 8 muaj pjesë e Kuvendit të Shqipërisë. "Jemi në këtë komunikim për të denoncuar pa u tërhequr manipulimin dhe mashtrimin e madh publik për skenarin

e zgjedhjeve. Ka arritur në dimension të tilla, që i çjerrin maskën qeverisë. Ka arritur në skandale të tilla që qeveria është turpi i këtij pushteti. Një kandidat për deputet që kërkon të mbështetë një parti, Bindjen Demokratike, Andi Përmeti me 25 prill e ka bërë betimin. Raportohet nga Kuvendi i përdhunuar sikur ka 6 muaj si deputet i Shqipërisë kur ka vetëm 4 javë. Një turp të tillë fiksojeni mirë në mendje. I deklaruar si i pavarur tani na përfaqëson një parti. Edhe sot kryeministri nuk ka hezituar të flasë për zgjedhjet e paprekshme, ja me këto zgjedhje me këtë deputet."

# Basha: Qeveria tranzitore e largimi i Ramës zgjidhin krizën

*Kreu i Partisë Demokratike nga Parlamenti britanik: Zgjedhjet e diktuar nga krimi janë rrënja e krizës*

## Basha

"Largimi i qeverisë dhe kryeministrit të kapur në flagrancë duke bashkëpunuar me krimin për të shkatërruar procesin zgjedhor të 2017 dhe krijimi i një qeverie tranzitore janë mënyra e vetme për zgjidhjen politike të krizës".



## Takimi

Kreu i Partisë Demokratike, Lulzim Basha ka zhvilluar dje një takim në Parlamentin britanik ku është pritur nga kryetari i Komisionit të Sigurisë dhe Inteligjencës, Dominic Grieve.



E dhe pse kreu të PD-së Lulzim Bashës iu bë thirrje nga drejtori për Ballkanin Perëndimor në Britaninë e Madhe, Andrew Page se duhet të ulet në tavolinë me Ramën pa kushte, Basha ka vijuar me qëndrimin e tij dhe opozitës joparlamentare. "Largimi i qeverisë dhe kryeministrit të kapur në flagrancë duke bashkëpunuar me krimin për të shkatërruar procesin zgjedhor të 2017 dhe krijimi i një qeverie tranzitore janë mënyra e vetme për

zgjidhjen politike të krizës" ka deklaruar Basha nga Parlamenti britanik. Basha në këtë vizitë u takua me kryesuesit e Grupit Parlamentar bipartizan për Shqipërinë në Parlamentin Britanik, deputetët John Grogan (kryetar i grupit) dhe Martin Vickers (nën kryetar). "Zgjedhjet e diktuar nga krimi janë rrënja e krizës, sepse kanë prodhuar një parlament të diktuar nga krimi dhe jo nga vota e shqiptarëve. Politikanet që janë kapur në bashkëpunim me krimin e organizuar për të vjedhur zgjedhjet e 2017-ës, duhet të ndëshkohen dhe jo të promovohen. Pa shpëputur lidhjet e kriminit me politikën nuk mund të ketë zgjedhje të lira dhe të ndershme. Largimi i qeverisë dhe kryeministrit të kapur në flagrancë duke bashkëpunuar me krimin për të shkatërruar procesin zgjedhor të 2017 dhe krijimi i një qeverie tranzitore janë mënyra e vetme për zgjidhjen politike të krizës", theksoi Basha.

Dominic Grieve nuk është hapur tema e zgjedhjeve, por është folur vetëm për luftën kriminale të organizuar dhe trafikun e drogës. Basha ka thënë se shumica absolute e shqiptarëve jetojnë dhe punojnë në Britaninë e Madhe ndershmërisht. "Ndaj veprimi i vendosur dhe bashkëpunimi i ngushtë në luftë kundër kriminit të organizuar dhe në veçanti trafikun të qenieve njerëzore e të narkotikëve, do të ndihmojë në goditjen e kriminalitetit dhe në rikthimin e besimit", tha ai. Sipas kreut të opozitës joparlamentare kjo do të shërbejë për të mos njollësuar reputacionin e komunitetit shqiptar në Britani nga një pakicë e përfshirë në aktivitete kriminale. "Jemi të vendosur për të ndërtuar në Shqipëri institucione të forta ligjzbatuese të pandikuara dhe të afta për të luftuar krimin e organizuar dhe narkotrafikun." ka thënë Basha.

## BALLKANI

Kreu i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, gjatë takimit me kryetarin r Komisionit të Sigurisë dhe Inteligjencës, Dominic Grieve, ka pohuar se shtetet e Ballkanit janë multietnike dhe se kjo është një vlerë evropiane, të cilën ne duhet ta mbrojmë. "Çdo ide tjetër rrezikon paqen dhe stabilitetin rajonal, hap precedentë të rrezikshëm në Ballkan dhe përtej Ballkanit, si dhe dobëson krahun jugor të NATO-s duke i shërbyer axhendave që janë në konflikt me sigurinë dhe vlerat euroatlantike."

## MBESHTETJA

## Lefter Koka 'garant' i Partisë Bindja Demokratike!

Lefter Koka zbulohet të jetë deputeti që ka dhënë firmën për të mbështetur Bindjen Demokratike për të pasur kandidatët për kryebashkiakë në zgjedhjet vendore 2019. Partia Demokratike dhe Lëvizja Socialiste për Integrim akuzuan këtë të shtunë partinë Bindja Demokratike të Astrit Patozit, për paligjshmëri në regjistrimin e kandidatëve për kryetar bashkie në zgjedhjet e 30 qershorit 2019. PD dhe LSI thanë se kandidatët e Bindjes janë të paligjshëm, sepse nuk mbështeten nga një mandat deputeti në të paktën 6 muajt e fundit. Në këto kushte, ishte Astrit Patozi, kryetari i Bindjes, që hodhi dritë mbi procesin e regjistrimit. Ai tha se deputeti që ka mbështetur dhe propozuar si kandidat për kryetar bashkie dhe anëtarë të këshillave bashkiakë, është Lefter Koka. Ky i fundit është deputet

i LSI-së i cili nuk hoqi dorë nga mandati, që tashmë është shpallur i pavarur në mbështetje të Bindjes Demokratike. Në një reagim në Facebook, Patozi publikoi edhe deklaratën e Lefter Kokës dorëzuar në KQZ, ku theksohet edhe klauzola që i jep fuqi ligjore vendimit të tij, zotërimi i mandatit për 6 muajt e fundit, ndryshe nga Andi Përmeti. Bindja Demokratike ka konkurruar në 26 bashki me kandidatë për kryetar bashkie, dhe në 55 të tilla për lista këshilli. Astrit Patozi, thotë se në shumë bashki kanë mundur të marrin edhe firmat e qytetarëve përveç të dy deputetëve. Sipas ligjit, në mungesë të mbështetjes nga të paktën 1 deputet që e ushtron detyrën të paktën 6 muajt e fundit, duhet marrë firma e qytetarëve, e 1 % të zgjedhësve të asaj njësie ku ka kandidatë si mbështetje për regjistrimin e tyre në KQZ.



## TAKIMI ME GRIEVE

Kreu i Partisë Demokratike Lulzim Basha ka zhvilluar dje një takim në Parlamentin britanik ku është pritur nga kryetari i Komisionit të Sigurisë dhe Inteligjencës, Dominic Grieve. Në këtë takim Basha theksoi se në Shqipëri duhet të forcohet shteti ligjor dhe demokracia si dhe duhet qëndruar krah për krah aleatëve euroatlantikë për të parandaluar çdo plan apo ide që minon interesat strategjike të NATO-s në Evropën Juglindore. Në takimin e tij me



# Faktet për Fredi Belerin, si e nxori nga gara ligji i dekriminalizimit

## Fredi Belerit i dënua me tre vite burg, e 'dogji' ligji i propozuar nga Basha, OMONIA akuzon shumicën

**K**omisioni Qendror i Zgjedhjeve i ka ndaluar kandidimin kreut të OMONIA-s, Fredi Belerit në zgjedhjet e 30 qershorit si kandidat i pavarur në Bashkinë e Himarës. Kaq ka mjaftuar që aleatët e Lulzim Bashës, OMONIA, të reagojë duke hedhur akuza ndaj mazhorancës për këtë vendim të KQZ. Por, si qëndron e vërteta e bazuar në fakte lidhur me rastin Beleri? Arsyja e moslejimit të futjes në garë të Belerit është ligji i dekriminalizimit nga aleati i Vangjel Dules, Lulzim Basha. Sipas ligjit të dekriminalizimit, propozuar nga Lulzim Basha dhe Partia Demokratike në 2017, për një dënim 3 vjeçar, zyrtari nuk mund të zgjidhet ose konkurrojë për një funksion publik për një periudhë 10 vjeçare pas përfundimit të dënimit.

### SI ËSHTË HISTORIA E BELERIT?

Ndaj Fredi Belerit ka një vendim të Gjykatës së Vlorës, e cila e ka dënua me 3 vite burg për akuzën e nxitjes së urrejtjes ndëretnike. Dënimi është dhënë pas ngjarjeve të vitit 2003 në një qendër votimi në Himarë, ku Beleri ishte protagonist në përplasjet e dhunshme dhe thirrjet antishqiptare që pasuan. Ai, së bashku me katër persona të tjerë

### Ndalimi

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i ka ndaluar kandidimin kreut të OMONIA-s, Fredi Belerit në zgjedhjet e 30 qershorit si kandidat i pavarur në Bashkinë e Himarës.



u dënua në mungesë me 3 vite burg. Gjithsesi, nëse ai do e kishte kryer dënimin prej 3 vitesh, do kishte dalë nga burgu nga në 26.12.2009. Kjo do të thotë që deri në 26.12.2019 ai do e kishte të ndaluar të kryente çfarëdo funksioni publik. Fakti është që ai iu shmang drejtësisë dhe nuk e shleu dënimin. Ai ka qëndruar në arrati deri në 26.12.2011, kur sipas ligjit të dekriminalizimit çështja ndaj tij u mbyll për shkak të parashkrimit. Sipas ligjit, ai nuk mund të kandidojë për 10 vite që nga momenti kur i është caktuar dënimi, pra në 26.12.2021. Por në këtë rast, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, i drejtuar nga opozita dhe me shumicën e anëtarëve nga opozita nuk kishin pse të interpretonin dy mundësitë, sepse edhe nëse

### Beleri

Beleri akuzon kryeministrin Edi Rama për vendimin e KQZ, ndërsa thotë se eliminimi i tij si kandidat i pavarur për Bashkinë e Himarës, ka një prapavijë të pastër politike.



Beleri nuk do ishte shmangur dënimit, ai nuk do të mund të kandidonte deri në dhjetor të 2019, megjithëse në këtë rast në 2021. Thënë të gjitha këto fakte, ajo që del e qartë është se pavarësisht deklaratave të aleatit të Bashës sot se mazhoranca po pengon Belerin, në fakt është ligji i propozuar nga Basha që e le jashtë gare. Të gjitha pretendimet e tjera janë pjesë e luftës absurde të Lulzim Bashës e Belerit, ku njëri ka dalë nga sistemi dhe kërkon të shkatërrojë vendin dhe demokracinë, ndërsa i dyti në shkelje flagrante të ligjit, kërkon të kandidojë.

### FREDI BELERI AKUZON RAMËN

Fredi Beleri ka reaguar për herë të parë, pasi KQZ-ja refuzoi

duke mos e regjistruar si kandidat për bashkinë e Himarës në zgjedhjet e 30 qershorit të këtij viti, pasi nuk kishte mbushur periudhën e rehabilitimit nga një dënim disa vite më parë. Ai akuzon kryeministrin Edi Rama për vendimin e KQZ, ndërsa thotë se "Eliminimi im si kandidat i pavarur për Bashkinë e Himarës, ka një prapavijë të pastër politike. Frika e Edi Ramës, është vota e lire e popullit". Beleri shprehet se KQZ shkeli ligjin pasi "është mbërthyer nga interesat okulte të qeverisjes antipopullore të Edi Ramës". Beleri thekson se dënimi në vitin 2006 nga Gjykata e Vlorës, ka skaduar përpara 3 viteve, pra në vitin 2016 dhe, kjo 'nuk përbën aspak pengesë që unë të kandidoj për Bashkinë e Himarës'. Por KQZ-ja mendon ndryshe (Sqarimi i plotë për refuzimin e kandidimit të Belerit). Megjithatë, ai thotë se nuk do ta lerë me kaq, por do ta apelojë vendimin e KQZ-së.

### REAGIMI I ATHINËS

Për këtë çështje reagoi dje edhe Ministria e Jashtme e Greqisë, e cila tha se vendimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nuk ka bazë ligjore. "Vendimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në Shqipëri për të mos lejuar kandidimin e zotit Beleri është tepër shqetësues. Me sa jemi në dijeni



deri më tani ky vendim nuk ka bazë ligjore. Jemi duke ndjekur zhvillimet dhe jemi të gatshëm të ndihmojmë përfaqësuesit e minoritetit", thuhet në reagimin e Ministrisë së Jashtme greke. Alfred (Fred) Bejleri është një emër i njohur, pasi ishte njëri nga anëtarët e komandos ekstremiste të masakrës së Peshkëpisë e ndodhur në 10 prill 1994 në Gjirokastrë. Pavarësisht asaj që kishte ndodhur në 1994 në Gjirokastrë, ai mori guximin dhe kandidoi për kryetar të bashkisë së Himarës në zgjedhjet lokale të 2015 në siglën e PBDNJ dhe i mbështetur nga opozita e djathtë, por nuk arriti që të fitonte. Ndërkohë që kandidoi sërish tani por u rrëzua nga KQZ, ndërsa dosja e Peshkëpisë është rihapur.

### OMONIA AKUZON RAMËN

Pas refuzimit të kandidaturës së Fredi Belerit (Dhionisios Alfred Petro Beleri) nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për zgjedhjet e 30 qershorit ka ardhur edhe reagimi i partisë Bashkimi Demokratik i Minoritetit Etnik Grek, OMONIA. Sipas OMONIA-s, mospranimi i kandidaturës së Belerit për Himarën

është një veprim joligjor dhe një represion i kryeministrit Rama. "Vendimi i Komisionit i referohet një penalteti që lidhet me mbrojtjen e kutisë së votimit, një ngjarje e cila është e pasqyruar edhe në Raportin e atëhershëm të OSBE. Fredi Beleri, i ndodhur përballë orgjisë së frikësimit të heleneve të Himarës dhe të manipulimit të rezultatit zgjedhor të zgjedhjeve vendore të vitit 2003, të vetmin akt që kreu së bashku me bashkëqytetarët e vet ishte mbrojtja e votës së bashkëqytetarëve dhe e parimeve të demokracisë. Tashmë janë të njohura metodat e qeverisë Rama dhe të vegëlës së tij të bindur, të kryetarit aktual të Bashkisë Goro për grabitjen e pronave dhe për vënien në dyshim të origjinës greke të banorëve vendalinj. Vendimi i tij është edhe një hallkë tjetër e shtuar në zinxhirin e veprimeve të tij në shërbim të dy synimeve të lartpërmendura. Është e padiskutueshme se argumentimi i vendimit të Komisionit do të bjerë poshtë para çdo gjykate shqiptare, por rreziku i humbjes së kohës së çmuar deri më atëherë është evident dhe i madh", thuhet në reagim.

## Dorëheqja pas skandalit në Austri, Balla: Po Basha pse s'mban përgjegjësi?

Kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, Taulant Balla ka reaguar pas dorëheqjes së liderit të djathtë

të të FPO, Heinz-Christian Strache në Austri. Përmes një postimi në Twitter Balla deklaroi se në Shqipëri lideri

i PD, Lulzim Basha përfitoi më shumë se 1 milion dollarë nga një kompani guackë nën pronësi ruse, duke tentuar të

rrisë mbështetjen e partisë së tij të djathtë në Washington dhe nuk mban asnjë përgjegjësi. Sipas Ballës, Basha

për afërën e lobimit rus është nën hetim në SHBA, Britaninë e Madhe dhe në Shqipëri. "Në Austri lideri i Partisë së Djathtë FPO Strache dha dorëheqjen pas regjistrimit video me një mbështetës ruse në shkëmbim të mbështetjes politike. Në Shqipëri lideri i PD Lulzim Basha përfitoi më shumë se 1 milionë dollarë nga një kompani guackë nën pronësi ruse, duke tentuar të rrisë mbështetjen e partisë së tij të djathtë në Washington. Basha është nën hetim në SHBA, Britaninë e Madhe dhe në Shqipëri", shkruan ai. Pas një video-skandali që u publikua në media dha dorëheqjen zëvendëskancelari austriak, Heinz-Christian Strache. Vendimi erdhi pasi dy gazeta gjermane, "Der Spiegel" dhe "Sueddeutsche Zeitung",



publikuan pamje filmike ku ai shfaqej tek i ofronte kontrata shtetërore një oligarkeje të dyshuar ruse, në shkëmbim të mbështetjes për fushatën zgjedhore.

### SHPALLJE ANKANDI

Pasuria nr. 184/4ND15, ZK 1557, vol 7, fq 3, lloji njsi me sip 450 m2, pajisur me çertifikatë pronësie. Pasuri e sekuestruar më parë Në vlerën e **396.000 (treqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë) LEKE**

Vendi ku do të zhvillohet ankandi i shitjes së sendeve është salla e mbledhjeve e Shoqërisë së Përmbarrimit "TDR GROUP" sh.p.k. e cila gjendet në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta" Kulla Nr. 5, Kati i 11-të, Nr.54 Tiranë

### SHPALLJE ANKANDI

Pasuria nr. 184/4ND9, ZK 1557, vol 6, fq 247, lloji njsi me sip 3000 m2 pajisur me çertifikatë pronësie. Pasuri e inskriptuar dhe e sekuestruar më parë është në vlerën prej **4.510.400 (katër milion e pesëqind e dhjetë mijë e katërqind) LEKE**

Vendi ku do të zhvillohet ankandi i shitjes së sendeve është salla e mbledhjeve e Shoqërisë së Përmbarrimit "TDR GROUP" sh.p.k. e cila gjendet në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta" Kulla Nr. 5, Kati i 11-të, Nr.54 Tiranë



# Shit-blerja e votave Dako pyetet për pesë orë te Krimet e Rënda

## Kryebashkiaku u jep përgjigje 20 pyetjeve të dy prokurorëve. Bisedat që nxorën emrin e Dakos

ELTON QYNO  
TIRANE

**K**ryebashkiaku i Durrësit Vangjush Dako është pyetur për gati pesë orë në Prokurorinë e Krimeve të Rënda, duke dhënë shpjegime lidhur me hetimin që ka nisur akuza për dosjen 339/1. "Shqiptarja.com" mëson se Dako është marrë në pyetje nga dy prokurorët e çështjes Vladimir Mara dhe Dritan Prenci, të cilët kanë kërkuar përgjigje nga Dako për gati 20 pyetje. Kryebashkiaku është pyetur në cilësinë e personit që ka dijeni për ngjarjen dhe jo si person nën hetim. Mësohet se Dako ka treguar rrethanat e njohjes me Avdylaj dhe personat të tjerë që janë përgjuar nga prokuroria. Ai ka treguar se nuk mund të dilte garant dhe të ishte i bindur plotësisht se në fushatën e tij zgjedhore, persona të ndryshëm, dashamirës, mund të

është i vetëm, saktësojnë burimet, pasi Dako po verifikohet edhe për punësime të paligjshme në njësitë administrative që drejton bashkia e Durrësit, pasi nga përgjimet janë konstatuar ndërhyrje dhe emërime jashtë kriterëve që parashikon ligji.

### DY BISEDAT QË NXORËN EMRIN E VANGJUSH DAKOS

Po kush janë bisedat që sollën kryerjen e verifikimeve? Deri tani tre janë përgjimet e publikuara ku Dako flet me anëtarët e bandës së Shijakut. Në bisedën e parë në datë 24 qershor, një ditë para zgjedhjeve të 2017, dikush flet me Altin Avdylin i njohur me pseudonimin "Nicen" dhe i thotë: "Kam ca me mbiemër Kurti, kam zonzjen këtu... po deshe...6 veta janë, thuaj Vangjushit t'i japim ndonjë lek, që të votojnë". Ndërsa në bisedën e dytë të publikuar, Dako gjatë komunikimit me Altin Avdylin interesohet që të takohet me një person tjetër i quajtur Astrit, i arrestuar të dielën e shkuar si kreu kësaj bande kriminale. Sipas transkriptit të kësaj bisede me Altin Avdylin, Vangjush Dako kërkon të takohet me vëllanë e tij, Astritin për ta falënderuar dhe folur për diçka, dy ditë pas zgjedhjeve të 2017. Ndërkohë që në një tjetër përgjim të publikuar nga Berisha, Dako është kapur duke biseduar me Jasin Avdylin, i cili po ashtu është i arrestuar.

### HETIME PËR PASTRIM PARASH PËR GRUPIN

Paralelisht me hetimin për trafik droge dhe verifikimet për Vangjush Dakon, prokuroria e Krimeve të Rënda, ka nisur hetim pasuror për të arrestuarit e operacionit "Vol-Vo 4". Astrit Avdylajt dhe anëtarët e familjes së tij në Shijak, tashmë janë bërë objekt dhe i hetimit pasuror. Perandoria e Avdylajt dhe biznesmenit tjetër të shpallur në kërkim Admir Hoxha, do i nënshtrohen një hetimi pasuror për të hedhur dritë mbi vënien e kapitalit pasuror nga këta persona. Admir Hoxha, që dyshohet se është ideatori i krijimit të laboratorit të zbuluar në Brenog të Hasit rreth 1 javë më parë, është shpallur në kërkim ndërkombëtar nga policia e shtetit. Hoxha zotëron pasuri në Tiranë, Durrës dhe në zonën e Rinasit. Ndërkohë që prej ditës së djeshme prokuroria e Krimeve të Rënda ka nisur procedurën duke kërkuar informacion të imtësishëm në hipoteka, banka dhe ALUIZNI. Ndërkohë kreu i këtij grupi kriminal Admir Hoxha, është shpallur në kërkim ndërkombëtar për rastin në fjalë dhe bashkë me të, janë shpallur në kërkim dhed dy shtetas Turq, të cilët kanë mbajtur kontakte me këta persona.



kenë ofruar para tek persona të tretë, me qëllim blerjen e votës. Përgjimet telefonike për operacionin "Vol-Vo 4", kanë nxjerë në skenë emrin e kryebashkiakut të Durrësit Vangjush Dako, i cili ka dalë në përgjime, teksa flet me Altin Avdylaj dhe emri i tij, përmendet nga persona të tjerë për blerje votash në Durrës, një ditë pasi të zhvilloheshin zgjedhjet e dorëzimit të detyrës, "Korrupsionin aktiv në zgjedhje" dhe "Ushtrim i ndikimit

të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike", kryer në formën e grupit të strukturuar kriminal. Për këto akuza burime

pranë prokurorisë së Krimeve të Rënda thanë për "Shqiptarja.com" se janë duke u kryer verifikime të imtësishëm, përfshirë këtu, Vangjush

Dakon, vllazërit Avdylaj dhe disa persona të tjerë, që kanë qënë pjesë e shtabit elektorale pranë Vangjush Dakos. Hetimi për krim zgjedhor nuk

### NGJARJA NË VLORË

## 26-vjeçari vlonjat plagos me thikë nënën

**N**jë 26-vjeçar u arrestua nga Policia e Vlorës, pasi ka plagosur me thikë nënën e tij dhe një person tjetër. Specialistët për Hetimin e Krimit pranë Komisarariatit të Policisë Vlorë pas konsultimit me Prokurorin, arrestuan G.M., 26 vjeç, banues në Vlorë. Policia thotë se ngjarja ka ndodhur për shkak të gjendjes së rënduar psikologjike të 26-vjeçarit. Ai do të hetohet nga Prokuroria e Vlorës për veprat penale "Dhunë në familje" dhe "Plagosje e lehtë me dashje".



### NGJARJA "ARREST ME BURG"


## Lihet në burg tropojani që qëlloi me bomba Molotov ndaj institucioneve e policisë

**A**rrest me burg" vendosi Gjykata e Tiranës për Marash Qerimin, 40-vjeçar nga Tropoja, i cili u arrestua pasi në protestën e opozitës joparlamentare më 11 maj, u zbulua nga filmimet se ka sulmuar institucionet dhe punonjësit e policisë me bomba molotov, kapsolla, flakadanë dhe sende të forta. Ai akuzohet për veprat penale "organizimi dhe pjesëmarrja

në grumbullime e manifestime të paligjshme", "kundërshtimi i punonjësit të Policisë së Rendit Publik", "goditja për shkak të detyrës", "shkatërrimi i pronës me zjarr" dhe "shkelja e rregullave mbi lëndët plasëse, djegëse dhe radioaktive". Nga goditjet, kundërshtimet dhe përdorimi i lëndëve piroteknike, sendeve të forta dhe bombave molo-

tot, mbetën të plagosur 16 punonjësit të Policisë, të cilët morën ndihmën në spitalin e Traumës. Si pasojë e përdorimit të bombave molotov, u shkakuan dëme të konsiderueshme në institucionet shtetërore. Policia po punon për identifikimin dhe kapjen e personave të tjerë të dyshuar, të përfshirë në këto veprime të kundërligjshme.





### Kapitulimi

"Pas diskutimeve të shumta e mori fjalën prof. Rexhep Uka, i cili duke analizuar pikën ku kishim mbërritur, bëri që të kapitulujë pa kushte Sali Berisha, duke pranuar humbjen dhe duke pranuar si të vetmen zgjidhje vendosjen e kandidatursë sime për president".

# Bamir Topi: Si i kërcënoi Berisha deputetët e PD pro meje në 2007

Ish-presidenti rrëfen për herë të parë paraskenat e drekës së Vlorës me 20 deputetët që dolën kundër Berishës në 2007 dhe si u kërcënuan më pas, çfarë përgjigje i dha Bujar Leskaj dhe dorëzimi i kryeministrit

ADRIATIK DOÇI  
TIRANE

Në ditët e para të marsit të 2007, Bamir Topi merr një telefonatë nga Sali Berisha, në atë kohë kryeministër, i cili i kërkon të zhvillojë një takim në mbrëmje. Gjatë takimit, Sali Berisha i thotë Bamir Topit se "Jam menduar gjatë këto kohë dhe besoj se kam bërë zgjedhjen më të mirë. Partia Demokratike do të propozojë ty si kandidatun më të mirë dhe më të përshtatshme për kryetar shteti. Askush më shumë se ty nuk mund të marrë votat dhe nga e majta në Parlament". Por, pasi kalon rreth 4 javë, sipas Bamir Topit, vjen akti i parë i tradhtisë së Sali Berishës. Prapaskenat e këtyre momenteve tensionuese i rrëfen ish-presidenti Bamir Topi e tij autobiografik me titull "Nocturn" (Kur arsyeja errësohet nga pushteti). Pasi e kishte propozuar si kandidat për President, Berisha nxjerrë Bujar Nishanin dhe Genc Rulin në një mbledhje të grupit parlamentar të PD, të cilët i kërkojnë Topit të tërhiqej, me pretendimin se mund të mos merrte votat e domosdoshme. Kjo çonte në rrëzimin e qeverisë dhe në zgjedhje të pakohshme. Një ditë pas debateve në grup, Bamir Topi mbledh në një drekë në Vorë rreth 20 deputetë të Partisë Demokratike duke i dhënë një mesazh të force Sali Berishës. Ky i fundit ishte në një pozicion të vështirë. "Të nesërmen vjen një ftesë nga miku im Bujar Leskaj për të drekuar së bashku me deputetë të tjerë në Vlorë, ftesë të cilën pranova me kënaqësi për t'u relaksuar sado pak nga Tensioni i Tiranës, për më tepër një qytet si Vlorë, ku shkoj gjithmonë me kënaqësi të veçantë. Ata ditë (e shtunë), u mbledhën në Vlorë, në restorant 'Platinium' më shumë se 20 deputetë, ndonëse jo të ftuar nga unë, por që u kuptua qartë si një mesazh që duhet të shkonte për



**Berisha**  
"Fjalën e merr menjëherë Berisha dhe sulmon drejtpërdrejt Bujar Leskajn, për të intimiduar gjithë grupin, duke i thënë: 'Ti je futur në strehën e gjarpërinjve, duke cituar më pas emra.'"

kryeministrin, që ai të kuptonte se grupi ishte i ndarë, ndryshe nga ajo që ai ishte mësuar të shikonte. Lajmi tashmë ishte shpërndarë, urdhrat nga Tirana ishin të prera për disa deputetë, të cilët filluan të lëkundën. Sapo u sistemuan në tavolinën e drekës, Bujar Leskaj u drejtohet deputetëve me shprehjen: Ta firmosim në të bardhë!, duke nënkuptuar listën e mbështetësve të kandidatursë sime për president. Tashmë 'lojën' po e luante në fushën e tij Bujari, një djalë intelektual dhe deputet i Vlorës, i cili ishte larguar nga Ministria e Kulturës pa ndonjë arsye për t'i hapur rrugë në atë institucion Ylli Pangos. Në këtë moment Edmond Spaho pyeti i çuditur: Çfarë liste?", shkruan Topi.

### PRESIONI NGA TIRANA, LËKUNDEN GJYSMA E DEPUTETËVE

Ish-presidenti Topi shkruan se pasi situata u qartësua, për shkak të presioneve nga Tirana, më shumë se gjysma e deputetëve nuk ishin më të vendosur. "Pasi gjithçka ishte qartësuar, biseda vazhdoi me një tension të brendshëm, ku realisht jo më shumë se 10 vetë ishin të vendosur, kurse të tjerët dukej që nuk e kishin kuptuar qëllimin e drekës. Pavarësisht nga situata e krijuar, ku dy-tre deputetë mbanin lidhje me kryeministrin nëpërmjet telefonit, tashmë ishte krijuar psikoza se unë kisha mbështetjen e nevojshme prej 20 vetash që duheshin ligjërisht për t'u futur në garë. Ndërkohë që drekës po i vinte fundi, gazetarët e medias në Vlorë kishin bllokuar rrugën pranë restorantit dhe prisnin prononcimin tonë. Në dalje Bujar Leskaj, lëshoi një batutë: Hapini rrugë presidentit! Më tej vazhdoi: -Ne nuk lejojmë që djali i Çajup Rusmalit të zgjedhë djalin e Thanas Nanos, duke nënkuptuar se Ilir Rusmalit dhe Fatos Nano ishin respektivisht djemtë e dy njerëzve të besuar të sistemit komunist që kishin shërbyer si drejtorë të Radiotelevizionit Shqiptar apo në institucione të tjera të propagandës së regjimit. Në përfundim të drekës u

shpreha nga timoni i makinës sime se kjo ishte vetëm një drekë mes miqsh. Ndërsa më vonë, pak çaste pas largimit tim, Bujar Leskaj kishte folur troç, duke dhënë sinjalin e fortë se ky grup, ose një pjesë e rëndësishme e tij, do të luftonin deri në fund që ajo që ishte deklaruar nga vetë Berisha të bëhej realitet për zyrtarizimin e emrit tim", vijon Topi.

### BERISHA KËRCËNON DEPUTETË PRO TOPIT

Ish-presidenti Bamir Topi rrëfen detaje se si Sali Berisha kërcënoi drejtpërdrejt deputetët që mbështesnin Topin si kandidat për president dhe që kishin marrë pjesë në drekën e Vlorës. Mes të sulmuarve, sipas Topit, ishte edhe Bujar Leskaj, i cili e përballoi presionin. "Të nesërmen, ditë e diel, ishte afati i dorëzimit të kandidatursë dhe për këtë arsye ishte thirrur mbledhja e grupit në mesditë. Kishte ardhur çasti i akumulimit të plotë të tensionit dhe gjithçka po shkonte drejt ndarjes. Fjalën e merr menjëherë Berisha dhe sulmon drejtpërdrejt Bujar Leskajn, për të intimiduar gjithë grupin, duke i thënë: 'Ti je futur në strehën e gjarpërinjve', duke cituar më pas emra. Bujar Leskaj i qëndroi burrërisht shantazhit të kryeministrit duke parë situatën e rëndë në planin moral, por edhe duke sinjalizuar për kujdes, se gjithçka mund të shkonte drejt shpërndarjes'. Më pas Berisha iu drejtua Sami Gjergjit duke e quajtur 'Makbeth', gjë që imponoi ndërhyrjen time të ashpër. Duke sikur pritej vetëm akti final i shthurjes së grupit parlamentar, i cili ishte ndarë qartë në pro dhe kundër. Pas diskutimeve të shumta e mori fjalën prof. Rexhep Uka, i cili duke analizuar pikën ku kishim mbërritur, bëri që të kapitulujë pa kushte Sali Berisha, duke pranuar humbjen dhe duke pranuar si të vetmen zgjidhje vendosjen e kandidatursë sime për president. Këtë

fjalë të prof. Ukës e kam quajtur 'Colpo di Grazia', shkruan Topi.

### HALLI I BERISHËS

Sipas Bamir Topit halli i vetëm i Berishës ishte ruajtja e pushtetit të tij dhe të mos shkonte në zgjedhje të parakohshme. "Halli i vetëm i Berishës ishte të mos shkonte në zgjedhje të parakohshme, që do të shënonte fundin e pushtetit të tij në kushte kur kishte krijuar një ndarje të thellë brenda partisë dhe sidomos në grupin parlamentar. Me gjithë situatën e vështirë brenda grupit, të cilën e krijoj vetë, Berisha kishte arritur në një moment të krizës së marrëdhënieve me mua personalisht, por edhe me një grup njerëzish kolegë e miq të mi, të cilët nuk e gëlltisin më sjelljen e padrejtë të kryeministrit. Ai e dinte mirë se edhe në kushtet kur ishte i detyruar të mbështeste emrin tim për president, marrëdhëniet do të ishin institucionale dhe jo më të ngrohta. Për këtë Berisha tentoi edhe një herë të mbledhë grupin parlamentar në një orë të vonë të mbrëmjes disa ditë para fillimit të procedurave zyrtare, në sallën e mbledhjeve të zyrave të Kuvendit. Takimi po zhvillohej në kushtet e një tensioni në rritje dhe ishte përgatitur mirë nga kryeministri, i cili kësaj radhe vendosi të mos fjalë vetë, por të hedhë në sulm dy njerëz me tipologji të ndryshme, por të gatshëm për t'u përdorur. I pari e mori fjalën Genc Ruli, një mik i vjetër nga koha e gjimnazit, politikan, intelektual dhe qytetar, nga i cili nuk e prisja që të ngrihet dhe të më bënte thirrje për tërheqje në emër të interesave politike të qeverisë. I dyti ngrihet ministri i Brendshëm i Berishës, Bujar Nishani, sikurse e kemi thënë, njeri i futur në politikë nga unë, ish-officer, intelektual mediokër dhe servil i Sali Berishës. Edhe ky filloi të moralizonte për tërheqja, duke më kthyer në atmosferën e mbledhjeve të viteve '70, kur klasa punëtore demonizonte intelektualët dhe i dënonte për shfaqje të huaja. Një inskenim i shëmtuar, a thua se këta kishin ardhur të vetëm në pushtet dhe duhej ta administronin atë si të donin".



ADRIATIK DOÇI  
TIRANE


**A**kuzon çdo ditë shumicën qeverisëse për kapjen e drejtësisë, por në të njëjtën kohë Partia Demokratike vazhdon përpjekjet që të fusë njerëzit e saj në kupolën e drejtësisë, siç operoi gjatë periudhës 2005-2013. Pikërisht deri në 2013 Partia Demokratike dhe presidenti i Republikës në atë kohë, Bujar Nishani kanë emëruar persona të besuar pranë Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese, po sot shumica e tyre janë shkarkuar nga Vetingu për pasuri të paligjshme, lidhje me krimin apo si të paafte. Konkretisht 6 anëtarë të emëruar nga PD janë detyrë nga frika e Vetingut, 3 u shkarkuan, 1 u dënua për korrupsion në Gjykatën e Lartë. Ndërsa në Kushtetuese 8 gjyqtarë po të emëruar në nga PD ose janë shkarkuar nga Vetingu, ose kanë dhënë dorëheqjen për të shmangur Vetingu duke shkaktuar mbyllje të dy gjykatave më të rëndësishme të vendit, mbyllje për të cilat çuditërisht sot PD akuzon qeverinë. Por paradoksi i PD-së nuk mbaron këtu. Çlirim Gjata, aktualisht Sekretar për Çështjet Ligjore në Partinë Demokratike, ka aplikuar për t'u bërë anëtar i Gjykatës Kushtetuese. Konkretisht, në mars të vitit 2018, Kuvendi i Shqipërisë shpalli një listë me 20 kandidatë, të cilët kishin aplikuar për një vend vakant në Gjykatën Kushtetuese. Pjesë e kësaj liste ishte edhe Gjata. Pra, në një kohë kur Lulzim Basha dhe Sali Berisha akuzonin Edi Ramën për kapjen e drejtësisë, sekretari i partisë së tyre Çlirim Gjata ishte në garë për t'u bërë pjesë e gjykatës më të rëndësishme në Shqipëri. Gjata ka marrë postin Sekretarit në PD në janar të këtij viti, por vetëm në datën 10 prill 2019 ai ka dhënë dorëheqjen nga gara, e njëjta ditë kur KED (institucioni i ri që i takojnë emërimet) ka thirrur Gjatën për të paraqitur dokumentacionin e për të nisur verifikimin dhe vlerësimin e tij si kandidat. Pra, tërheqja e tij ka ardhur në momentin që Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka nisur procedurat për të verifikuar pastërtinë e figurës, ku përfshihet edhe kontrolli i pasurisë, gjë që Çlirim Gjata ka preferuar ta shmang si shumë kolegë të tjerë.

DORËHEQJA DHE  
PRETENDIMET

Shqiptarja.com ka siguruar kopje të shkresës për tërheqjen. Paradoksi deri në grotesk është se Çlirim Gjata, përmes kësaj letrë drejtuar Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, deklaroi tërheqjen nga gara, me argumentin se qëllimi i qeverisë është që të kapë këtë gjykatë. Pra ai që është drejtues i Partisë Demokratike duhet të garantojë pavarësinë e Gjykatës Kushtetuese nga politika, por u detyrua të tërhiqet nga gara, pasi sipas tij qëllimi i qeverisë sot është të kapë këtë gjykatë nëpërmjet rrethanave, manovrave dhe shërbimeve të institucionit të KED. Prandaj procesi i përzgjedhjes së anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese më duket një hipokrizi në plot kuptimin e fjalës".

SI QËNDRON E VËRTETA? GJATA  
NUK PLOTËSON KRITERET

Po si qëndron e vërteta e dorëheqjes nga gara të Çlirim Gjatës për një vend vakant në Kushtetuese? Pse Gjata kishte besim tek Këshilli i



Paradoksi

Çlirim Gjata, aktualisht Sekretar për Çështjet Ligjore në Partinë Demokratike, ka aplikuar për t'u bërë anëtar i Gjykatës Kushtetuese dhe mas pas ka dhënë dorëheqjen, ndërsa PD akuzon shumicën për kapjen e drejtësisë.



plotëson kriteret për t'u bërë anëtar i Gjykatës Kushtetuese. Duke qenë i vetëdijshëm se do të përjashtohet nga gara për shkak të kriterit politik, Gjata i ka paraprirë këtij vendimi duke shmangur Vetingu dhe duke u dorëhequr nga gara e duke sulmuar KED si përfaqësues i PD.

PO CILIN KRITER NUK  
PLOTËSON GJATA?

Pika 'c' e nenit 7/a, të ligjit për Gjykatën Kushtetuese, i ndryshuar në vitin 2016 në kuadër të reformës në drejtësi, parashikon që kandidati për anëtar të Gjykatës Kushtetuese, përpos të tjerave duhet të "të mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike dhe të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit". Në rastin konkret, Çlirim Gjata është Sekretar për Çështjet Ligjore në Partinë Demokratike, që nga janari i këtij viti fakt që e skualifikon menjëherë nga gara.

KONTRADIKTA E GJATËS

Me atë urrëjtje patologjike që drejtuesi i Partisë Demokratike tregon ndaj çdo institucioni që nuk e kontrollon, në letrën e tij, drejtuar Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, Çlirim Gjata zhvlerëson kandidimin e tij për t'u bërë pjesë e gjykatës më të rëndësishme në Shqipëri. Ai i thotë se kishte harruar se ishte kandidat. "Sapo i njoftova me e-mail, që brenda datës 10 të këtij muaji duhet të paraqitem për, siç shpreheni ju, procesin e verifikimit, vlerësimin, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve time për anëtar të Gjykatës Kushtetuese, gjë për të cilën unë kam shprehur interesin. Është e vërtetë se kam shprehur interes për kandidim për në institucionin në fjalë, por ka diçka një vit apo e gjysmë më parë, që kam bërë këtë paraqitje kandidimi, aq sa e kisha harruar se jam kandidat për në Gjykatën Kushtetuese". Ndërkohë, më poshtë në letrën e tij, Gjata ka një tjetër vlerësim për Gjykatën Kushtetuese. "Dy herë në historinë e Evropës ka ndodhur të mbyllet Gjykata Kushtetuese. Ajo në Austri në 1938 nga Hitleri dhe here e dytë në Shqipëri në vitin 2018 dhe çfarë paradoksi, për shkak të reformës në drejtësi", shkruan Gjata, duke harruar se të gjithë gjyqtarët e emëruar nga Partia Demokratike nëse do të kishin respektuar ligjet, ata sot do kishin kaluar Vetingu dhe do ishin në krye të detyrës, duke garantuar funksionalitetin e plotë të Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës Kushtetuese. Nga Gjykata Kushtetuese, janë tetë gjyqtarë të emëruar me votat e shumicës PD-LSI në Parlament që janë larguar duke shkaktuar bllokimin e saj (tre të dorëhequr dhe 5 të përjashtuar nga komisioni i Vetingut) Nga Gjykata e Lartë janë 10 anëtarë të emëruar nga PD dhe LSI që më tej janë larguar duke shkaktuar bllokimin e saj, 4 të shkarkuar nga Vetingu, njëra e dorëhequr, dhe 5 të larguar të cilëve u kanë mbaruar mandati.


# PD tenton të kapë Kushtetuesen, por Çlirim Gjata u tërhoq nga frika e Vetingut

## Ja si PD do të kapë Gjykatën Kushtetuese. Kandidon Çlirim Gjatën por u tërhoq për të shmangur Vetingun dhe se nuk plotëson kriterin e depolitizimit. Gjata (nga PD) i shkruan KED-së: U tërhoqa sepse ju jeni institucioni i kapur

E vërteta

Gjata thotë se jep dorëheqjen pasi qeveria po kap Gjykatën Kushtetuese përmes KED, por e vërteta është se Gjata duhet të kalonte Vetingun e pasurisë dhe se nuk plotëson kushtin e mos mbajtjes së pozicioneve drejtuese në parti politike 10 vitet e fundit.

Emërimeve në Drejtësi deri në 10 prill 2019 dhe nuk ka më besim pas kësaj date kur ka nisur verifikimi tij? Kush po tenton të kapë Kushtetuesen, shumica apo PD që synoi të bëjë anëtar të kësaj gjykate sekretarin e saj? E vërteta e dorëheqjes është se Çlirim Gjata nuk





# Prangoset në sallën e gjyqit, militani i PD, shpërndante drogë

## Lavdosh Demaj u lirua në Elbasan por Apeli në Durrës vendosi ta rikthejë në qeli sërish

ELTON QYNO  
TIRANE

Lavdosh Demaj, kryetari i grupseksionit të Partisë Demokratike në Elbasan, është arrestuar në sallën e gjyqit, pasi ndaj tij Gjykata e Apelit në Durrës, ka vendosur ti heqë masën e sigurisë "detyrim paraqitje" dhe të vendosë masën e "arrestit në burg". Kjo masë sigurie ishte kërkuar nga prokuroria e Elbasanit, në Gjykatën e Shkallës së Parë, por çuditërisht i akuzuari për tregtim dhe shpërndarje të kokainës e heroinës, është lënë i lirë nga gjyqtari Taulant Tafa. Por prokurori i çështjes ka vendosur ta apelojë lirimin e Lavdosh Demaj, duke kërkuar rikthimin e tij në qeli. Pak ditë më parë gjykata e Apelit Durrës ka vendosur të pranojë kërkesën e prokurorisë, duke urdhëruar rikthimin në burg të Lavdosh Demaj.

### ARRESTIM NË SALLËN E GJYQIT

Demaj, që rezultoi dhe kryetari i grupseksionit të Partisë Demokratike në Elbasan,

mësohet të jetë arrestuar në sallën e gjyqit dhe shoqëruar në dhomat e paraburgimit. Dy agentë me numra serialë "315" dhe "317" janë ata që çuan prapa hekurave Klajdi Gjeëin, Klaudio Trungun, si dhe katër persona të tjerë si persona që ishin përfshirë në tregtinë e drogës në Elbasan dhe Tiranë. Hetimi disa mujor i prokurorisë së Elbasanit, ka zbardhur mënyrën se si vepronin shitësit e Kokainës në dy qytete, ku për klientët që blinin lëndën narkotike, premtorin se do u gjenin dhe vajza gratis, për dëfrim. Një ofertë e tillë i është bërë agentit "315" nga i arrestuari Skënder Pllumbi. Policia dhe prokuroria e Elbasanit kanë kryer një sërë përgjimit duke dokumentuar veprimtarinë kriminale të 6 personave. Për shkak se në shitjen e kokainës ishin të implikuar më shumë persona, policisë i është dashur të futë në aksion dhe një agent tjetër të koduar me numrin "317". Për blerjen e drogës personat flisnin në mënyrë të koduar, duke pohuar se kërkonin "... një serbator e gjysmë naftë...". Sipas të dhënave nga policia e Elbasanit mes personave

### TË ARRESTUARIT

KLAUDJO TRUNGU

AGRON QAFA

SKENDER PELLUMBI

LAVDOSH DEMAJ

LORENCIO GJINI

KLAJDI GJEÇI

JANË VËNË NËN HETIM NË GJENDJE TË LIRË

A. LL.

O. O.

A. F.

që shiste kokainë ishte dhe Klaudio Trungu, i cili është menaxheri i lokalit "My Brother", që dyshohet se i përket njërit prej anëtarëve të fisit "Çapja" në Elbasan, Bledar Muçës.

### BLERJA E SHTATË DOZAVE KUNDRE 275 MIJË LEKËVE

Në datën 31 mars 2019, në orën 11:53, Skënder Pllumbi komunikoi me agentin "315", i cili i thotë se po vjen. Në

këtë moment Skënderi merr në telefon Lavdosh Demaj dhe e pyet se ku është. Pas 5 minutash, Skënder Pllumbi takohet me agentin, ndërkohë Lavdosh Demaj i bën zile në orën 12:18 dhe 12:19. Nga ana tjetër Skënder Pllumbi, nga raporti i vëzhgimit rezultoi se është çuar nga tavolina në orën 12:36, shkoi në rrugën "Thoma Kalefi", takoi një person aty për rreth 1 minutë, më pas ecën në këmbë dhe ndalon në rrugën "Todi Dhomo", te një banesë 4-katëshe (banesa e Lavdosh Demaj), takoi një person të moshës 30-35 vjeç dhe kthehet te lokali. Më pas takohet përsëri me agentin "315" dhe futen në makinën e këtij të fundit. Agjenti i jep shumën prej 275 mijë lekësh të vjetra dhe merr një sasi prej

7 dozash, të supozuara nga gjysmë grami.

### SYNIMI PËR TË BLERË 500 GRAMË KOKAINË

Por siç ishte biseduar edhe në takimin e një dite më parë, ndërmjet Klajdi Gjeçi, Skënder Pllumbi dhe agentëve të policisë gjyqësore me numra të koduar 315 dhe 317, në datën 12 prill 2019, rreth orës 11:30, janë takuar pranë terminalit tek Ekonomiku. Pas bisedimeve të bëra në lidhje me cilësinë e lëndës narkotike dhe pagesës, agjenti "317" ka skuar të shikojë "mallin", i cili presupozohet të ishte në sasinë prej 500 gramësh, lëndë e dyshuar si "kokainë". Në këtë moment, nga ana e oficerëve të policisë gjyqësore është bërë edhe arrestimi

në flagrancë i Klajdi Gjeçi dhe Skënder Pllumbi. Nga të dhënat e grumbulluara gjatë veprimeve të para hetimore, ka dyshime të arsyeshme, të mbështetura në prova, që personat nën hetim Agron Qafa, Lorencio Gjini, Klaudio Trungu dhe Lavdosh Demaj, në bashkëpunim me shtetasin Skënder Pllumbi, kanë mbajtur me qëllim shitjen dhe shpërndarjen e lëndës narkotike të llojit "kokainë", duke konsumuar elementet e figurës së veprës penale "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve", në bashkëpunim. Në momentin e ndalimit, oficerët kanë konstatuar se gjatë kontrollit personal, personi nën hetim Agron Qafa, mbante me vete një sasi prej 25 gramësh kokainë.

## Shpërndanin kokainë e kanabis në Tiranë, kapen 4 persona dhe procedohen dy të tjerë

Policia e Tiranës ka finalizuar dy operacione ku në pranga kanë rënë tre persona të cilët shpërndanin kokainë si dhe një të ri tjetër i cili është kapur me kanabis. Në operacionin e koduar "Orët e Vona" që u krye në rrugën "Sulejman Delvina" në një lokal "Bar kafe" në pranga kanë rënë: A.B., 31-vjeç, A.K. 23-vjeç, E.M. 26-vjeç, si dhe është proceduar në gjendje të lirë shtetasi A.D. 26-vjeç. Në këtë lokal persona të ndryshëm e frekuentonin duke pirë e shpërndarë lëndë narkotike. Nga kontrolli i kryer nga punonjësit e policisë, në ambientet e lokalit të cilin e kishte me qera dhe menaxhonte 31-vjeçari, A. B., Policia gjeti dhe sekuestroi 12 doza të dyshuara me lëndë narkotike kokainë. Në momentin e kontrollit nga Policia në lokal ndodheshin personat A. B., A. K., E. M. dhe A. D., të cilët janë



shoqëruar dhe në përfundim të veprimeve është bërë arrestimi në flagrancë i personave E.M., A.K., A.B., u procedua në gjendje të lirë shtetasi A.D., si dhe u sekuestruan në cilësinë e provës materiale, 12 doza kokainë. Ndërkohë në një

tjetër operacion Policia e Shtetit ka vënë në pranga një 21-vjeçar me iniciale R.T si dhe ka proceduar në gjendje të lirë L.B. 21-vjeçarit ju sekuestruan edhe një shumë lekësh të dyshuara si të përfutuara nga shtija e lëndës narkotike.

### OPERACIONI

## Shkodër, i shpalluri në kërkim ndërkombëtar, në pranga edhe një 55-vjeçar për armë e drogë

Policia e Shkodrës ka vënë në pranga një 28-vjeçar me iniciale E.G.J të shpallur në kërkim nga autoritetet italiane pasi Gjykata e Pistoia në Itali kishte caktuar për të masën e sigurisë "Arrest me burg". Mbi 28-vjeçarin rëndon akuza e veprës penale Vjedhje në rrethana rënduese" ku maksimumi i dënimit është 5 vite heqje lirie. Po ashtu policia e Shkodrës ka vënë në pranga një person të moshës 55-vjeç në fshatin Dragoç. Gjatë kontrollit të ushtruar në banesën e tij policia ka gjetur një kallashnikov, municione luftarake si dhe disa fidanë kanabis. Gjatë kontrollit të ushtruar në banesën e tij, Policia gjeti dhe sekuestroi në cilësinë e provës materiale një armë zjarri kallashnikov dhe municion luftarak, si dhe në oborrin e banesës së tij ju gjetën të kultivuar disa fidanë Cannabis Sativa. Materialet iu referuan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër për veprime të mëtejshme për veprat penale "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit" dhe "Kultivimi i bimëve narkotike".





# Fëmijët, si veprohet kur kalon afati 60-ditor i regjistrimit

## Procedura e posaçme për fëmijët që lindin jashtë territorit të vendit

**M**e dy udhëzime të ministrit të Brendshëm, Sandër Lleshaj, caktohen procedurat se si vepron administrata shtetërore për të regjistruar fëmijët, kur prindët kanë kaluar afatin ligjor të regjistrimit, apo kur fëmija ka lindur jashtë dhe mungon plotësimi i rubrikës së emrit.

### AFATI

Me Udhëzimin e parë bëhet përcaktimi i rregullave të hollësishme dhe procedurës administrative, që zbatohet nga zyrat e gjendjes civile dhe njësia për mbrojtjen e fëmijës në bashki, në rastin kur nuk është bërë regjistrimi i fëmijës në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile të vitit 2010 brenda 60 ditëve nga data e lindjes.

Kur nëpunësi i gjendjes civile konstaton se nuk është kryer regjistrimi i fëmijës së lindur në Regjistrin Kombëtar brenda 60 ditëve nga data e lindjes, njofton me shkresë zyrtare për këtë fakt, drejtuesin e strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki, duke bashkëlidhur të gjithë dokumentacionin përkatës.

Drejtuesi i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki dërgon për trajtim shkresën pranë njësisë për mbrojtjen e fëmijës, brenda 24 orëve nga paraqitja e saj. Në rastin e Bashkisë Tiranë, shkresa i dërgohet çdo njësie administrative që ka njësi të veçantë të mbrojtjes së fëmijës.

Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës, pranë njësisë për mbrojtjen e fëmijës administron shkresën dhe dokumentacionin e dërguar nga nëpunësi i gjendjes civile, si dhe çdo akt tjetër që nxjerr sipas këtij udhëzimi, duke krijuar dosje të veçantë për çdo fëmijë të peregjistruar.

Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës ka të drejtë të kërkojë informacion shtesë nga nëpunësi i gjendjes civile, i cili duhet të përgjigjet brenda 24 orëve nga paraqitja e kërkesës.

Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës kontakton menjëherë me prindin ose prindërit e fëmijës të peregjistruar në Regjistrin Kombëtar. Në pamundësi të kontaktit me ta, kontakton me çdo person, që mund të deklarojë lindjen e fëmijës. Në pamundësi për të kontaktuar edhe me këta persona, i drejtohet subjekteve të bashkisë.

Pasi punonjësi për mbrojtjen e fëmijës kryen procedurat për regjistrimin, nëse fëmija regjistrohet, ai harton raportin përmbledhës për veprimet e kryera, pjesë e të cilit është edhe konkluzioni për mbylljen e dosjes; nëse fëmija nuk është regjistruar, punonjësi për mbrojtjen e fëmijës, në bashkëpunim me nëpunësin e zyrës së



### Procedura

Me Udhëzimin e parë bëhet përcaktimi i rregullave dhe procedurës kur nuk është bërë regjistrimi i fëmijës në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile të vitit 2010 brenda 60 ditëve nga data e lindjes

gjendjes civile, përcaktojnë emrin e fëmijës, hartojnë aktin e lindjes dhe e nënshkruajnë atë.

Emri i fëmijës, së regjistruar sipas kësaj procedure, është "i përkohshëm" dhe mund të ndryshojë vetëm me kërkesë të personave dhe sipas procedurës, të përcaktuar sipas dispozitave përkatëse të ligjit nr. 10129, datë 11.5.2009, "Për gjendjen civile", të ndryshuar, për këtë rubrikë dhe vetëm në këto raste.

### JASHTË VENDIT

Objekt i Udhëzimit të dytë është përcaktimi i procedurës administrative, që zbatohet nga zyrat e gjendjes

civile, për regjistrimin e fëmijëve në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, në rastet kur në aktin e lindjes së tyre të mbajtur jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë është e paplotësuar vetëm rubrika e emrit të fëmijës.

Kërkesa për pasqyrimin e të dhënave të aktit të lindjes, të mbajtur jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, me rubrikën e paplotësuar të emrit, paraqitet nga të dy prindërit/prindi ose nga çdo person i parashikuar sipas ligjit "Për gjendjen civile", i ndryshuar. Kërkesa paraqitet në zyrën e gjendjes civile ku kanë vendbanimin prindërit/prindi.

### Emri

Objekt i Udhëzimit të dytë është përcaktimi i procedurës, që zbatohet për regjistrimin e fëmijëve kur në aktin e lindjes së tyre të mbajtur jashtë territorit të Shqipërisë është pa plotësuar emri

Personi deklarues paraqet në zyrën e gjendjes civile ku kanë vendbanimin: kërkesën e nënshkruar prej tyre, sipas formularit 1, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi, pjesë përbërëse e tij; dokumentin origjinal të aktit të lindjes, i cili është në formën e kërkuar nga ligji me vulën "APOSTILLE", por që ka të paplotësuar rubrikën e emrit; deklaratën me shkrim për emrin që do të mbajë fëmija, duke përjashtuar emrat që janë parashikuar nga aktet nënligjore në fuqi, si të papërshtatshëm për t'u mbajtur.

Po kështu, duhet të paraqesë kopje të letërnjoftimit dhe prokurën

e posaçme, kur nuk është asnjë nga prindërit deklarues.

Nëpunësi i gjendjes civile, pasi ka administruar dokumentacionin, regjistron fëmijën në Regjistrin Kombëtar me emrin që kanë deklaruar deklaruesit.

Në rastin kur akti i lindjes, i mbajtur jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, ka rubrikën e emrit të paplotësuar dhe nuk përmban vulën "APOSTILLE", atëherë nëpunësi këshillon deklaruesin për procedurën ligjore të vendosjes së vulës "APOSTILLE" në aktin e lindjes, kur ai shprehet se do ta kryejë vetë këtë procedurë. Kur i interesuari është në pamundësi ta kryejë vetë këtë procedurë, nëpunësi i gjendjes civile duhet të hartojë një procesverbal në të cilin provon se i interesuari ka depozituar në zyrën e gjendjes civile aktin e lindjes së fëmijës, të mbajtur jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, me rubrikën e emrit të paplotësuar; të sqarojë deklaruesin për tarifën financiare që duhet të paguajë për këtë shërbim dhe mënyrën e arkëtimit të saj.

Nëpunësi i gjendjes civile, aktin e lindjes të mbajtur me procesverbal, si dhe kopjen e mandatit të arkëtimit në bankë të tarifës, e dërgon me shkresë zyrtare Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile brenda 48 orëve dhe kjo e fundit e përcjell te strukturat përkatëse të ministrisë përgjegjëse për punët e jashtme brenda 48 orëve nga data e marrjes. Në këtë rast, deklaruesit i jepet një kopje e procesverbalit, ku të jenë shënuar edhe kontaktet e nevojshme të tyre, së bashku me adresën e tij.

Deklaruesit kryejnë pagesën e tarifës së përcaktuar, në numrin e llogarisë bankare të ambasadës apo konsullatës përkatëse, ku do të dërgohet akti për vendosjen e vulës "APOSTILLE". Këto numra llogarie publikohen pranë çdo zyre të gjendjes civile.

Kur deklaruesi, risjell në zyrën e gjendjes civile aktin e lindjes së mbajtur jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, me rubrikën e emrit të paplotësuar në të cilën është vendosur vula "APOSTILLE", nëpunësi i gjendjes civile kryen procedurën e mësipërme të regjistrimit.

Në këtë rast, procedura e regjistrimit fillon pasi mbërrin zyrtarisht në zyrën e gjendjes civile që e dërgoi, akti i lindjes i pajisur me vulën "APOSTILLE". Pasi merr aktin në formën e kërkuar, nëpunësi i gjendjes civile njofton deklaruesin dhe, pas paraqitjes së tij, fillon procedurën e parashikuar.

Pas përfundimit të kësaj procedure, nëpunësi i gjendjes civile pajis deklaruesin me certifikatën e lindjes së fëmijës së regjistruar.

### TREGTIA E JASHTME

## Eksportet në rënie 2.3 për qind në katër muajt e parë të vitit

**M**uajt e parë të këtij viti nuk kanë qenë pozitivë për ecurinë e eksporteve. Pas një përmirësimi të lehtë në mars, ato i janë rikthyer sërish tkurrjes së lehtë në muajin prill, me -0.24%. Si rrjedhojë, për 4 muajin u eksportuan jashtë vendit mallra me vlerë 99 miliardë lekë, me një rënie prej 2.3% në raport me janar-prillin e 2018-s. Performanca e dobët në prill ishte kryesisht nga

"Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike", eksportet e të cilit u përgjysmuan. Edhe për katërmujorin, eksportet e këtij grupi ranë me 25% me bazë vjetore, duke zbritur në gati 15 miliardë lekë (15% e totalit, duke kaluar në grupin e tretë më të madh të eksportuar). Tekstilet dhe këpucët e kanë rimmarrë veten, pas rënies së lehtë të muajve të parë, duke rikuperuar

në prill. Për 4-mujorin, ky grup, që është më i madhi, me gati 42% të totalit të eksporteve, ka shitur jashtë 41 miliardë lekë mallra, me një rënie të lehtë prej 0.6%.

Materialet e ndërtimit dhe metalet, kanë kaluar sërish në grupin e tretë më të madh në vend me 16% të totalit. Eksportet për 4-mujorin ishin 16 miliardë lekë, me një rënie prej 8% me bazë

vjetore, por që vjen nga performanca negative e dy muajve të parë, ndërsa në prill u rritën me 13%.

Në rritje të ndjeshme ishin dhe eksportet e ushqimeve, pijeve dhe duhanit, që u zgjeruan me 18%, duke përbërë 10% të totalit të eksporteve.

Deficiti tregtar arriti vlerën 106 miliardë lekë, duke u rritur me 8.9%, krahasuar me 2018-ën.







# “Parada e krenarisë”, puthje e përfaqime në marshimin sensibilizues

## Përfaqësues të komunitetit LGBT kanë marshuar në kryeqytet për të drejtat e tyre

Për të tetin vit, është zhvilluar në Tiranë, “Parada e krenarisë”, ku përfaqësues të komunitetit LGBT kanë marshuar në kryeqytet për të drejtat e tyre. Aleanca LGBT dhe Pro LGBT, komuniteti i Lesbikeve, Gay, Biseksualëve dhe Transeksualëve kanë marshuar dje në Tiranë, kundër diskriminimit dhe paragjyqimeve me të cilat përballen çdo ditë. Marshimi ka nisur rreth orës 12:30 në “Parkun Rinia”, dhe vijoi drejtë zonës së ish-Blokut, për tu kthyer tek presidenca, e për të ecur më pas drejtë bulevardit që të çon tek kryeministria. Në marshim nuk kanë munguar thirrjet e tyre si “Shteti hesht, ne guxojmë”, apo “Jemi lezbike, jemi krenare”. Gjatë marshimit ata janë ndalur edhe tek kryeministria ku i kanë bërë thirrje kryeministrit Edi Rama për mbështetje.

Në fjalën e mbajtur përpara godinës së kryeministrit, aktivistja e njohur e komunitetit LGBT Xheni Karaj, i ka kujtuar kryeministrit rastet e shumta diskriminuese ndaj këtij komuniteti. Karaj ka kërkuar nga Rama që ti bashkohet kësaj parade, pasi anëtarët e këtij komuniteti janë votues dhe taksapagues të rregullt të shtetit. “Unë



i bëj thirrje sot kryeministrit. Kjo është parada e 8 që ne zhvillojmë, dhe në asnjë paradë nuk keni pasur

guximin të dilni dhe të ecni pranë LGBT, të cilët janë qytetarët tuaj, taksapaguesit tuaj, dhe janë pjesë

e kësaj shoqërie”, tha Xheni Karaj. Mesazhi i tyre është i qartë, kërkojnë hapësira për të jetuar të lirë me

zgjedhjet e tyre. Ndërsa nuk kanë munguar as mesazhet inkurajuese ndaj atyre që ende jetojnë të mbyllur, të dhunuar, apo të paragjykuar, nga shoqëria. “Në radhë të parë nëse doni të dilni nga guaska dhe të jetoni jetën që jepet vetëm njëherë, doni ta shijoni të plotë, filloni doni veten. Dashuria për veten ndihmon të dilni nga guaska. “Edhe kur të jeni të rrëzuar, edhe kur të jeni të vrrarë, buzëqeshni.”, shprehen mbështetës të komunitetit. “Jam këtu për t’i dhënë mbështetje LGBT. Kam ardhur nga Sarajeva enkas për ta.” “Mesazhi është që të jesh vetvetja, pavarësisht se kostot mund të jenë kosto super të larta”.

Kjo është parada e 8 e zhvilluar në Tiranë në ditën kombëtare të LGBT. Në këtë paradë morën pjesë aktivistë LGBTI nga i gjithë rajoni, mbështetës, aktivistë dhe pjesëtarë të komunitetit LGBTI nga Shqipëria, por edhe qytetarë të thjeshtë. Protesta i tyre është garantuar edhe nga uniformat blu, të cilat i kanë shoqëruar përgjatë gjithë marshimit, duke mundësuar lirin e rrugëve nga qarkullimi i automjeteve. Ata kanë parakaluar te bulevardi “Dëshmorët e Kombit” për të pedalar dhe apeluar në Ditën Ndërkombëtare Kundër Homofobisë dhe Transfobisë.

## MJEKU: NUK TREGOHET KUJDES

# 100 raste të reja me sëmundje seksualisht të transmetueshme!

Në Shqipëri nuk ka të dhëna të sakta për sa i përket sëmundjeve seksualisht të transmetueshme. Edhe pse rastet janë në rritje, sensibilizimi për këtë çështje kaq delikate është i pakët, ndërsa shumë persona të infektuar nuk e dinë që janë mbartës të ndonjë virusi. Mjeku infektionist në QSUT, Arjan Harxhi shprehet për Report Tv se vitin e kaluar janë ekzaminuar mbi 100 raste me infeksione SST, të cilat kryesisht vijnë si pasojë e marrëdhënieve seksuale të pambrojtura. “Mungojnë raportimet e sakta, në lidhje me ato që ju i quajmë sëmundje seksualisht të transmetueshme. Sëmundja më madhore, apo infeksioni më madhor, është infeksioni I HIV/AIDS. Edhe pse themi që Shqipëria është një vend me prevalencë të ulët, trendi është në rritje. Në këto vitet e fundit, ka çdo

vit mbi 100 raste të reja me infeksion HIV/AIDS. Një infeksion tjetër I pranishëm, me numër rastesh në rritje është sifilizi. “, shprehet Arjan Harxhi. Në një kohë ku antibiotikët sa vijnë e po bëhen më rezistentë ndaj infeksioneve, ekzaminimi në kohë i tyre është mjaft i rëndësishëm. Mjeku Harxhi bën apel veçanërisht për gratë shtatzënë të cilat duhet të kryejnë domosdoshmërisht testet. “Përgjithësisht infeksionet virale janë të patrajtueshme. Për shembull HPV, nuk trajtohet. Për shumë nga këto infeksione mund të ketë trajtime, por mbetet problem shfaqja e rezistencës. Përshtypja ime si specialist është që edhe në Shqipëri mund të kemi probleme me rezistencën ndaj antibiotikut të këtyre infeksioneve. Kemi pasur vjet 3 raste me sifiliz të gratë shtatzëna, duke i bërë apel atyre apo edhe mjekëve që



i kontrollojnë për të kryer të gjitha ekzaminimet”, tha Arjan Harxhi. Infeksionet STT, në pjesën më të madhe të rasteve janë të fjetura dhe nuk shfaqin simptoma tek të infektuarit. Kjo bën që pjesa më e madhe e tyre të kapen në një periudhë të vonuar, duke ulur ndjeshëm shanset për kurim të plotë. Aktualisht në vend infeksionet më të përhapura janë HPV, Sifilizi, por edhe HIV/AIDS.

## Çelet sezoni turistik

# Leli: Vlora qytet i sigurt, zgjidhni destinacion të pushimeve tuaja

Vlora e cilësuar si ‘perla’ e rivierës shqiptare është gati të presë turistët e diellit dhe të rërës. Me një atmosferë plot energji, mes aktiviteteve kulturore, sportive, panairëve të shumëllojshëm e me një koncert të madh ku performuan emrat më të mirë të momentit, Vlora hapi zyrtarisht sezonin turistik të vitit 2019. Kren i bashkisë së këtij qyteti, Dritan Leli u shpreh se Vlora të tillë atmosfere do ketë gjatë gjithë verës. “Ky koncert është një ogur i mirë për sezonin veror të vitit 2019. Ky sezon do të jetë më i suksesshmi i të gjitha viteve dhe një shembull për të gjithë vendet që bëjnë turizëm. Dua t’ju them të gjithëve që Vlora është vend i sigurt dhe të gjithë familjet mund të vijnë në Vlorë, të jetojnë në Vlorë se është një vend i sigurt. Por qëllimi është që familjarët të vijnë në Vlorë që të kalojnë pushimet. Vlora ka shumë për të thënë dhe ka shumë për të treguar dhe mikpritja e Vlorës është mikpritja, vlera më e madhe që ky qytet ka”, tha kryebashkiaku Dritan Leli. Me brigjet e saj, Karaburunin, Sazanin, Llogoranë, kalanë e Kaninës, Lagunen e Nartës, plazhet e shumtë, monumentet dhe gatimet, Vlora gjithnjë e më shumë po frekuentohet nga turistët vendas dhe të huaj.





# Simptomat e varësisë nga droga e alkooli

## Enkelana Lekli, psikologe klinike sqaron se cilat janë çrregullimet psikologjike që shkaktohen nga përdorimi substancave narkotike

**N**ë emisionin e mirënjohur "Këndi i Ekspertit" në Report TV, të drejtuar nga gazetarja Valbona Mhilli, në rubrikën "Mjeku im" këtë të javë ka qenë e ftuar Enkelana Lekli, psikologe klinike pranë

Spitalit SALUS. Mjekja ka folur për një temë mjaft të ndjeshme për varësinë ndaj drogës dhe alkoolit. Ekspertja jonë ka sqaruar se çfarë konsiderohet varësi patologjike dhe se cilat janë simptomat? Ajo ka treguar se cilat janë llojet e varësisë më të përhapura në vendin tonë dhe se cilat janë çrregullimet psikologjike që shkaktohen nga përdorimi i substancave narkotike, Mjekja Enkelana Lekli ka shpjeguar se pse duhet të kërkojmë ndihmë. Më pas ajo u është përgjigjur pyetjeve live të qytetarëve.

**Sot do të flasim për varësinë ndaj drogës dhe alkoolit. Çfarë konsiderohet varësi patologjike? Cilat janë simptomat?**

**Cilat janë llojet e varësisë më të përhapura në vendin tonë?**

**Cilat janë çrregullimet psikologjike që shkaktohen nga përdorimi i këtyre substancave narkotike? Pse duhet të kërkojmë ndihmë?**

Kjo është një temë shumë e ndjeshme për sa u përket të rinjve, sidomos për ata që kanë rënë pre e këtyre veseve.

Si fillim dua të shpjegoj se çfarë është varësia, në tërësi. Çdo qenie njerëzore është e varur, lind e varur, jemi të varur nga prindërit tanë, jemi të varur nga ambienti ku ne jetojmë, jemi të varur nga politika, nga ekonomia dhe nga gjëra më rutinë, nga gjërat më të vogla, të cilat ne i kryejmë në përditshmërinë tonë. Koncepti i varësisë është i lidhur shumë ngushtë me konceptin e kënaqësisë. Përpara se të shpjegoj varësinë patologjike, duhet të shpjegoj se çfarë është kënaqësia. Kënaqësia është një ndjenjë, është një eksperiencë të cilën individi e përjeton në një moment të caktuar të jetës së tij. Kjo kënaqësi sjell aspekte fizike pozitive dhe aspekte psikologjike pozitive, domethënë ndikon pozitivisht. Të njëjtën gjë kur kjo kënaqësi bëhet edhe më e kërkueshme në përditshmërinë e individit, atëherë kjo shndërrohet në varësi patologjike.

Varësia patologjike është një luhajtje e sjelljes, pra nga një sjellje normale ditore bëhet një sjellje patologjike. Ky është ndryshimi midis asaj çfarë quhet varësi dhe varësi patologjike.

**Si mund ta kuptojmë se cilat janë sjelljet patologjike më të rënda? Si mundet një prind të kuptojë që fëmija e tij ka rënë pre e kësaj patologjie?**

Në moshën e adoleshencës janë ato eksperiencat e para, ku edhe adoleshentët përdorin në mënyrë sporadike, sepse nuk mund të themi se një 17-18-vjeçar është i varur patologjikisht nga droga, nga alkooli apo nga lojërat e fatit. Fillon në një mënyrë sporadike sepse ndikohet nga ambienti, nga njerëzit që e rre-



thojnë, nga shokët. Një nga mënyrat është edhe ajo për t'u bërë pjesë e rrethit shoqëror, prandaj edhe adoleshenti ndjek shembujt që ndjekin edhe shokët e tjerë. Fillimisht, ai bie nga mësimet, d.m.th. ky fëmijë nuk ka më interes për shkollën, nuk ka më interes për librat, dëshiron që të jetë gjithmonë i rrethuar nga njerëzit, të dalë jashtë kontekstit familjar. Ndërsa në familje ndodh komplet e kundërta. Ai dëshiron të rrijë i vetmuar, të mos flasë shumë, sepse ka frikën se mund të dallohet. Një karakteristikë tjetër është edhe nervozizmi, sidomos kur prindërit e pyesin më tepër për shkollën apo për jetën sociale që ai ka jashtë kontekstit familjar. Kërkon të dalë natën nga shtëpia, kërkon të frekuentojë pub-et e natës.

**Ekziston mundësia për të rënë pre në club-et e natës?**

Nëse këto dalje bëhen gjithnjë e më të shpeshta, patjetër, sepse siç e thashë më përpara, ky adoleshent ndikohet nga shoqëria.

**Cilat janë disa simptoma të tjera, që prindi të kuptojë se diçka nuk shkon me fëmijën e tij?**

Agresiviteti, irritimi, debatet dhe përgjigjet jo normale, daljet e vazhdueshme. Në rastin e përdorimit të marijuanës kemi skuqje të syve. Këto janë disa prej simptomave. Janë një sërë faktorësh, të cilët bëjnë që një individ, pra jo vetëm adoleshentët, të bëhet pre e alkoolit, e drogës apo të lojërave të fatit. Mund të jetë edhe si një konsekuencë e një abuzimi fizik, e një abuzimi psikologjik apo e një abuzimi seksual që mund të jetë bërë ndaj këtij individi. Mundet

që individi të vijë nga një familje disfunktionale, nga një familje në të cilën ushtrohet dhunë, ku ngrihet zëri, jo vetëm ndaj këtij individi, që mund të jetë djali apo vajza, por edhe kundrejt nënës. Për fat të keq, në familjet shqiptare ekziston ende ky fenomen i theksuar i maskilizmit, ku ushtrohet ende dhunë. Kjo është një nga arsyt. Një arsye tjetër është kur njëri prej pjesëtarëve të familjes është përdorues i lëndëve narkotike apo i alkoolit. Tendencë që edhe fëmija të ndjekë po të njëjtën rrugë, është akoma dhe më e madhe.

**Cilat janë llojet e varësisë, më të përhapura në vendin tonë?**

Në vendin tonë varësitë janë të shumta. Kemi varësitë ndaj drogës, të cilat ndahen në disa tipe. Më të përhapurat në Shqipëri janë heroina dhe kokaina. Mund të themi që në vendin tonë, sipas një studimi të huaj që është bërë, janë rreth 70 mijë persona konsumatorë të këtyre dy llojeve droge. Por, më tepër e përdorur është kokaina. Edhe alkooli është shumë i përdorur sidomos nga moshat e dyta dhe nga moshat e treta. Por edhe ludopatia ose, siç e quajmë ndryshe, frekuentimi i lojërave të fatit. Deri para disa kohësh, kur në Shqipëri ishin të lejuara lojërat e fatit apo llotosportet, shumica e njerëzve e kishte maninë për ta provuar një herë fatin. Duhet të themi gjithashtu që jemi edhe një vend i varfër për sa i përket aspektit ekonomik dhe shpresa për të gjetur një mënyrë alternative për të fituar, është shumë e madhe.

**Në klinikën tuaj, a vijnë të rinj dhe të reja për të kërkuar ndihmë?**

Patjetër që vijnë.

**Çfarë mund të themi diçka më tepër? Të rinjtë vijnë vetë apo interesohen prindërit e tyre? Ju përmendët një shifër të madhe përdoruesish, por a trajtohen?**

Në Shqipëri format më të përdorura janë alkooli dhe drogat, të cilat ndahen në disa kategori: drogat depresante, si heroina, marijuana; drogat stimulante, si kokaina; droga halucinogjene, si ketamina, LSD-ja etj. Këto janë më të përhapurat.

**A është e vështirë të komunikosh dhe t'i ndihmosh këta persona, sepse disa vijnë vetë dhe për disa të tjerë interesohen familjarët. Mund të na jepni pak më shumë informacion, sepse për këtë temë na kanë shkruar shumë njerëz, të cilët ndoshta kanë nevojë për ndihmë, por edhe ngurrojnë.**

Aktualisht në vendin tonë, deri para pak kohësh, i vetmi repart apo i vetmi vend në të cilin trajtoheshin problemet e varësisë nga alkooli dhe nga droga, ishte repartit i toksikologjisë në QSUT. Në të njëjtin repart, për fat të keq, trajtohet edhe një individ, i cili tenton të vetëvritet, duke përdorur helme të ndryshme, apo edhe një individ, i cili shtrohet në këtë repart për arsye se e ka pickuar një insekt helmues apo një gjarpër. Por, që të flasësh për varësinë, është një botë më vete. Varësia trajtohet në shumë aspekte sepse është një çrregullim i cili prek shumë aspekte. Ajo prek aspektin emocional, aspektin psikologjik, fizik dhe shpirtëror. Prandaj, varësia duhet që të trajtohet nga një ekip terapeutik shumë i gjerë. Ajo nuk

mund të trajtohet vetëm nga mjeku apo vetëm nga psikologu.

**Ju folët për QSUT-në. A disponojmë ne mundësi për t'i trajtuar ashtu siç duhet të gjithë ata persona që kanë nevojë, sepse me gjithë dëshirën për t'i ndihmuar mundësitë mund të jenë të pakta nga familjarët e tyre. A janë të kushtueshme terapistë për këto raste?**

Unë nuk mund të them një çmim fik. Siç thashë edhe më lart, qenia njerëzore është racionale. Kjo varet edhe nga sasia e lëndës së konsumuar, nga kohëzgjatja e këtij konsumimi. Ne e shikojmë këtë formë patologjike nga shumë këndvështrime, si nga ana fizike ashtu edhe nga ana psikologjike. Fillimisht ka një proces trajtimi. Hapi i parë është konsulta me mjekun specialist toksikolog, i cili këshillon disa analiza për të parë gjendjen fizike dhe organike të pacientit. Pasi merret përgjigja e këtyre analizave, bëhet konsulta me mjekun internist, i cili bën një vlerësim të pacientit dhe nga ky vlerësim vendoset nëse pacienti duhet të bëjë ekzaminime shtesë, ka nevojë për një shtrim detoksifikimi në kushte spitalore apo ka nevojë thjesht për hyrjen në programin terapeutik. Dhe këtu nuk mund të flas për çmime.

**Sa mund të zgjasë një terapi?**

Terapia mjekësore e detoksifikimit mund të zgjasë një javë apo 10 ditë, por për këtë vendos mjeku toksikolog dhe mjeku internist, sepse mund të kemi pacientë që vijnë me probleme të ndryshme si cerozë, apo kanë probleme me mushkëritë, me zemrën. Për këtë duhet të bëhet edhe një check-up i limituar, për të parë gjendjen fizike të pacientit dhe më pas futjen në një program terapeutik.

**Flas nga Vlora. Nipi im ka qenë në emigrim në Zvicër. Nga ana mendore nuk është mirë dhe po dobësohet akoma më shumë. Ndoshta mund të ketë konsumuar ndonjë substancë narkotike në Zvicër. Mendoj kështu sepse ka qenë njeri shumë i rregullt dhe që kur është kthyer nga Zvicra dëshiron të rrijë vetëm, të flejë vetëm në shtëpi, pi vetëm duhan, ushqehet pak. Si mundemi ta ndihmojmë?**

Sigurisht që diçka ka ndodhur me këtë të ri, sepse ai shfaq një ndryshim rrënjësor. Kjo mund të ndodhë edhe si pasojë e largimit të tij nga Shqipëria apo e rikthimit të tij në Shqipëri. Mund të jetë si pasojë edhe e konsumimit të ndonjë substance. Nuk mund ta evitoj këtë si mundësi. Por, pa u takuar dhe pa biseduar me vetë personin, nuk mund të arrij në përfundimin nëse është apo jo konsumator i substancave narkotike. Duhet biseduar patjetër nga afër me të, sepse qenia njerëzore është shumë racionale dhe ndoshta as edhe me dy-tre takime nuk arrin ta shfaqë sepse ndoshta edhe vetë ai nuk arrin ta kuptojë problemin e tij. Mua më gjejnë në Spitalin SALUS.





# 15 ditë me radhë festival tek "Reja, 214 artistë nga 18 shtete"

**P**ër të tretin edicion radhazi, nisi dje Festivali i Resë, "Cloud Fest", ku për 15 ditë me radhë, 214 artistë nga 18 shtete të botës, do t'i dhurojnë publikut kryeqytetas një performancë ndryshe në muzikë, balet etj, duke krijuar një atmosferë fantastike.

Në nisje të festivalit, përshëndeti edhe kryetari i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj, i cili tha se Festivali i Resë ia ka dalë që të bëjë një ndërthurje të asaj që është Tirana sot.

"Janë shumë ata që na kanë dhënë një dorë, rreth 18 organizata, agjenci, ambasada, grupe të ndryshme nga gjithë bota, ndaj jemi munduar që të bëjmë një gërshetë me performanca, e një fije nga ky gërshet janë thesaret si Agim Molla, si sazet, si ahengu i Tiranës, e shumë thesare prej trevave tona. Të dielën kemi performancën nga Japonia, më pas nga shumë shtete të tjera. Prandaj, jemi munduar të bëjmë një ndërthurje të asaj që është Tirana sot. 18 herë, në të 18 gjuhët tuaja, ju falenderoj që keni pranuar të jeni pjesë e këtij gërsheti dhe jam mirënjohës sepse "Reja" u kthye nga një tufë shufrash hekuri, në një institucion", tha Veliaj.

*Kryebashkiaku Erjon Veliaj flet për edicionin e tretë: Nga një tufë shufrash hekuri, "Reja" kthehet në një institucion që prodhon art*



Instalacioni i Resë është ideuar nga artisti i mirënjohur japonez Sou Fuxhimoto, ku nga vendosja e

saj pranë Galerisë së Arteve ia arriti që të shndërrohet në një mjedis kulturor, me aktivitete të shumta

për publikun. Veliaj tha se ky instalacion ka krijuar reputacionin e tij kudo në botë dhe ka marrë

një dimension edhe më të madh se veprat e arkitektit të njohur japonez.

Ai ftoi publikun e Tiranës që të ndjekë programin e pasur artistik që do të ofrohet në këtë skenë moderne në natyrë. "Stresohemi e dramatojmë kot, shumë zhurmë për asgjë, ndërkohë që harrojmë se ka qark shumë arsye për të qenë të gëzuar dhe për të qenë bashkë. Deri në datën 30, do ketë gjithmonë diçka te "Reja", tha Veliaj.

Përgjatë ditëve dhe netëve të festivalit, artistët më të mirë vendas dhe të huaj do të sjellin tek Reja ndërthurjen më të mirë midis dy ekstremitëve të kulturës (artit, muzikës, dancit dhe ndërthurjeve të tyre) të kulturës bashkëkohore. REJA dhe lulishtja e saj do të jenë hapësirat e teatrit fizik, instalacioneve audio-vizuale, bashkëbisedimeve me artistë, lojërave piknike e after-party, performanca të artit dhe dancit bashkëkohor, muzikë dhe kërcim, paradë me Led, rituale, tambure japoneze, kërcim egjiptian, ërkshope, leksione spirituale, kërcim TAP dhe Irlandez, performanca letrare, trajnime 8-ditore për artin e performancës, leksione në universitete për menaxhim të karrierës artistike si artist i pavarur.

## DREJTORIA E ARKIVAVE

# Vula e fermanit 400-vjeçar daton e humbur më 7 maj

**N**ë materialin e referuar në Prokurorinë e Tiranës thuhet se në datë 10 maj 2019, pas një njoftimi nga drejtori i Përgjithshëm i Arkivave, për humbjen e një vule të një fermani të Manastirit të Kamenës, oficerët e Policisë kanë shkuar në vendin e ngjarjes. Ky ferman daton rreth viteve 1600. Oficerët që kanë shkuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave kanë konstatuar se: Në ambientet e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, konkretisht në Godinën B, ku bëhej edhe skanimi i materialeve të formateve të mëdha, ishte konstatuar mungesa e një vule, e cila ishte pjesë përbërëse e një fermani të Manastirit të

Kamenës. Vula kishte qenë e lidhur nëpërmjet disa penjve me këtë ferman dhe për herë të fundit është parë që ka qenë në vendin e saj në datën 7 maj 2019, nga të gjithë punonjësit e Sektorit të Evidencës në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave.

Ka ndodhur shpesh, që elemente apo pulla, që janë pjesë e dokumenteve në Arkivën e Shtetit të humbasin, e disa janë gjetur me vonë. Rasti më i fundit është vjedhja e një singjili (monedhë) që i përket shekullit të 17 të dosjes nr. 2 që sipas drejtuesit të këtij institucioni Ardit Bido, rasti i është referuar policisë. Dokumenti është me rëndësi historike kombëtare, sipas drejtorit Bido, por

nuk është pjesë e koleksioneve të rralla të arkivit.

Sipas tij ai është një singjil i një dokumenti, sepse vula nuk është unikalë. Më herët informacioni ishte se u grabit

Policia ka bërë hetimet, ndërkohë sipas drejtuesit të arkivës "Bëhet fjalë për stampën e vulës. Singhelium është monedha metalike që lidh çdo dokument. Nuk është unikalë, por çdo dokument ka qenë lidhur. I përkiste vitit 1700. Përgjegjësia e materialit ka një procedurë e caktuar, nuk ka akses çdokush, dhe i përket dosjes nr.2. Në rastin konkret është pjesë e një hetimi, ne bëjmë hetimin administrativ. Medaljoni unikal i dosjes 7 ekziston, nuk


ka humbur". (Fermanet janë dekrete të kohës së Turqisë-red) Rreth këtij problemi ka reaguar edhe drejtoresha e arkivave Nevila Nika e cila shprehet se "Vula është pjesë e një fermani të veçantë, të Sulltanit në gjuhën greke. Fermani i jep të drejtën e pronave Manastirit të Kamenës. Ndryshe nga vulat e tjera që kanë qenë prej dylli, kjo vule është në material metalik, prej plumbi", u shpreh Nika. Sipas Nevila Nikës ky ferman, bashkë me vulën e tij, kanë qenë të ekspozuara me rastin e 50-vjetorit të Arkivës së Shtetit në Muzeun Kombëtar dhe ka qenë i përfshirë dhe në katalogun e Mesjetës dhe Rilindjes së Arkivës së Shtetit.






## Kokomani & Lezho

# Letra e rrallë e dy gazetarëve që tronditi diktaturën komuniste



Burgu i Spaçit



NGA SKIFTER KËLLICI

### PROLOG

Në ditët e para të vitit 1979 në biseda me disa shokë të ngushtë mësova se dy miqtë e mi të mirë, gazetarët e talentuar Fadil Kokomani dhe Vangjel Lezho, me të cilët në vitet 1958-1963 kisha punuar edhe unë si gazetar në Radio Tirana dhe që kishin rreth 16 vjet që vuanin në burgjet dhe kampet komuniste të përqendrimit, ishin pushkatuar. Dhe bashkë me ta edhe një i burgosur tjetër, Xhelal Koprencka. Arsyeja ishte se dy të parët, dhe më pas edhe i treti, veç e veç, u kishin dërguar letra Hysni Kapos, (edhe

për Komitetin Qendror të PPSH-së), në të cilat u kërkonin atyre që të mënjanonin nga udhëheqja Enver Hoxhën që po e veçonte Shqipërinë nga bota... Kaq pata mësuar atëherë dhe asgjë më shumë. Madje dhe kjo ishte e tepërt, po të marrim parasysh se Sigurimi famëkeq me anë të hafijeve të veta që gëlonin kudo, i kishte sytë hapur e veshët pipëz.

Në Bibliotekën Kombëtare punonte asokohe një grua shumë e afërt me Fadil Kokomani, por sidoqoftë, edhe kur pas disa vjetesh, me shumë drojë mora guximin ta pyesja për fatin e tij dhe Vangjelit,

ajo m'u përgjigj se nuk dinte gjë...

Kjo ndodhi vetëm pas vitit 1985, pra pas vdekjes së Enver Hoxhës. Atëherë patëm zemër të bënim edhe pyetje të kësillojshme. Pra, atëherë, ndonëse përi nën zë, morëm e dhamë me shokë dhe mësuam se ato që hamendësoshin për Fadil Kokomani, Vangjel Lezhon dhe Xhelal Koprenckën ishin të vërteta. Me fjalë të tjera, që ata u kishin shkruar letra Hysni Kapos dhe...

vijon në faqet 14-17



## Arif Gjyli, përshtatësi i parë i Eposit të Kreshnikëve

Shkrimtari Arif Gjyli vdiq, më 23 shtator në moshën 76 vjeçare, në Tiranë. Emri dhe veprimtaria e tij e luftës dhe ajo letrare u kujtuan vetëm nëpërmjet një shkrimi. Më vonë, koha vërtetoi se, ky shkrim-kujtimi ishte i fundit, por jo përmendja e emrit, e kontributit të tij si mësues e didakt (nga të parët që u mor gjerësisht e me hollësi me problemin e mprehtë të teksteve të leximit dhe të letërsisë për fëmijë), krijues e studiues (ka meritën për vënien në pah për të parën herë, të figurës së poetit popullor tiranas Zenel Bastari dhe të një vlerësimi poetik - analitik të jetës dhe problematikës së veprës të Migjenit).

NGA XHAHID BUSHATI

faqe 18-19



## Ngjarja e rrallë, një pako me florinj në postën e Tiranës

Kjo ndodhi në vitin një mijë e nëntëqind e tridhjetë e ca. Nuk e di mirë. Kur ma tregoi im atë, Micenkoja, isha i vogël, në atë moshë kur interesi përqëndrohet te topi dhe lojrat dhe jo në ngjarje që ledhatojnë shpirtin. Ka vite, me dhjetra, që im atë nuk është më dhe ndoshta vetëm rastësia, apo kërkimi me një vëshirësi absolute në arkiva do të mundet të përcaktojë vitin, gjë që nuk e shpresoj...

NGA FREDERIK STAMATI

faqe 20

**Pas burgut 25-vjeçar/** Pse u ridënuan me pushkatim dy gazetarët e Radio Tiranës

**8 korrik 1978/** Si iu kundërvunë diktatorit, Kokomani, Lezho dhe Xhelal Koprencka



NGJARJA | HISTORIA

# Kokomani & Lezho

## Letra e rrallë e dy gazetarëve që tronditi diktaturën komuniste

NGA SKIFTER KËLLICI

**PROLOG**

Në ditët e para të vitit 1979 në biseda me disa shokë të ngushtë mësova se dy miqtë e mi të mirë, gazetarët e talentuar Fadil Kokomani dhe Vangjel Lezho, me të cilët në vitet 1958-1963 kisha punuar edhe unë si gazetar në Radio Tirana dhe që kishin rreth 16 vjet që vuanin në burgjet dhe kampet komuniste të përqendrimit, ishin pushkatuar. Dhe bashkë me ta edhe një i burgosur tjetër, Xhelal Koprencka.

Arsyeja ishte se dy të parët, dhe më pas edhe i treti, veç e veç, u kishin dërguar letra Hysni Kapos, (edhe për Komitetin Qendror të PPSH-së), në të cilat u kërkonin atyre që të mënjanonin nga udhëheqja Enver Hoxhën që po e veçonte Shqipërinë nga bota...Kaq pata mësuar atëherë dhe asgjë më shumë. Madje dhe kjo ishte e tepërt, po të marrim parasysh se Sigurimi famëkeq me anë të hafijeve të veta që gëlonin kudo, i kishte sytë hapur e veshët pipëz.

Në Bibliotekën Kombëtare punonte asokohe një grua shumë e afërt me Fadil Kokomanit, por sidoqoftë, edhe kur pas disa vjetesh, me shumë drojë mora guximin ta pyesja për fatin e tij dhe Vangjelit, ajo m'u përgjigj se nuk dinte gjë...

Kjo ndodhi vetëm pas vitit 1985, pra pas vdekjes së Enver Hoxhës. Atëherë patëm zemër të bënim edhe pyetje të kësillojshme. Pra, atëherë, ndonëse përi nën zë, morëm e dhamë me shokë dhe mësuam se ato që hamendësoheshin për Fadil Kokomanin, Vangjel Lezhon dhe Xhelal Koprenckën ishin të vërteta. Me fjalë të tjera, që ata u kishin shkruar letra Hysni Kapos dhe, për më tepër, mësuam se një ndër përcaktimet e tyre për Enver Hoxhën, ishte se ai po e mënjante vendin tonë nga bota.

Po cila ishte përmbajtja e këtyre letrave? Këtë nuk e dinte askush dhe nuk kishte si ta dinte. Kjo mbeti mister edhe pas rrëzimit të komunizmit.

Aty nga tetori i vitit 1994, kur po shkruaja librin "Historia e Radio-televizionit Shqiptar, (1938-1990)", për të mësuar më shumë për Fadil Komomanin dhe Vangjel Lezhon, veprimtarinë krijuese të të cilëve si gazetarë do ta trajtoja në këtë libër, duke u ndalur veçanërisht te letra misterioze drejtuar "Kupolës së Kuqe" nga burgu i Spaçit, u takova me publicistin dhe shkrimtarin e njohur Fatos Lubonja. Ai kishte kaluar së bashku me ta disa vjet të dënimit të tij 17-vjeçar në burgun e mësipërm dhe po shkruante librin "Ridënimi", një pjesë e mirë e ngjarjeve të të cilit u kushtohet atyre të dyve dhe Xhelal Koprenckës.

Fatos Lubonja, jo vetëm më rrefeu fakte që nuk i dija, por edhe më dhuroi për t'i përdorur në librin tim "Historia e ..." fragmente të fjalës së fundit të Fadil Komomomit dhe Vangjel Lezhos, pasi trupi gjykoes

**Si iu kundërvunë diktatori Hoxha dy gazetarët e burgosur Kokomani dhe Lezho 8 korrik 1978, e pas tyre edhe Xhelal Koprencka, sot të tre martirë të demokracisë...**



► Burgu i Spaçit

u kishtë dhënë atyre dënimin me vdekje.

Gjatë hulumtimeve të tij nëpër arkiva, Lubonja kishte arritur të njihet me këtë dokument me shumë vlera, që dëshmonte që ata të dy, edhe pse dënoheshin me vdekje jo vetëm nuk kërkonin falje, por vazhdonin të demaskonin regjimin totalitar stalinist të Enver Hoxhës. Por kur e pyeta për letrën që ata të dy dhe pastaj veçmas edhe Xhelal Koprencka u kishin drejtuar udhëheqësve komunistë, ai ngriti supet. Atyre letrave nuk kishte arritur deri atëherë t'u binte në gjurmë.

Dhe ja, para disa ditësh, si rrufe në qiell të hapur, mora vesh se në dy gazeta të përditshme ishte botuar letra e gjatë e panjohur deri tani, për të cilën shkrova pak më sipër!... Pra, pas 31 vjetësh, saktësisht shkruar më 8 korrik 1978.

(Për letrën e Xhelal Koprenckës deri tani asnjë e re. Ajo nuk është zbuluar ende). Por, sidoqoftë, zbulimi dhe botimi i letrës së Fadil Kokomanit dhe Vangjel Lezhos përbën një ngjarje të madhe, e cila, duke pasur parasysh edhe fjalën e tyre pas vendimit të dhënë nga trupi gjykoes që i dënonte me vdekje, pjesë të së cilës do të citoj në vazhdim të këtij dossieri, është një dokument i rrallë që dëshmon për qëndresën, guximin dhe trimërinë e pashembullt të tyre.

Dhe kjo, sepse ata, ndonëse e dinin që pas dërgimit të kësaj letrë nuk i priste veçse vdekja, ua përplasën të vërtetën në fytyrë udhëheqësve komunistë dhe drejtpërdrejt Enver Hoxhës, për të cilin pa asnjë ngurrim, veç përcaktimeve të tjera me të cilat do të njihemi, duke përdorur shprehjen e njohur të Luigji 16-të: "Shteti jam

unë", ("L'Etat c'est moi"), e cilësojnë diktator si çdo mbret tiran dhe despot që nëpërkëmb të drejtat me elementare të popullin të vet.

Ose, më saktë, sic venë në dukje ata, ai që si "Ali pasha, i cili që i detyruar të vdesë si qen i rrahur, i rrethuar vetëm nga 20 besnikë, kërkon mbi kurbanët e vet, mbi kockat e tyre kërkon të ngrejë një kështjellë të pamposhtur. Ai... që i përngjan aq shumë...atij."

Eshtë e vertete që lexues që janë njohur dhe njihen me përmbajtjen e plotë të kësaj, që gjendet në internet, kanë mbetur të habitur nga shprehje të Fadil Kokomanit dhe Vangjel Lezhos me anë të të cilave e quajnë veten "komunistë dhe publicistë të brumosur që të vegjëll me idetë e Toritit të Madh, të Leninit dhe të PK të BS...". Dhe kjo sepse ata studiuin në shkollë të larta të Bashkimit Sovjetik,


(1953-1959), përkatësisht i pari në Lenigrad (1952-57) dhe i dyti në Moskë, (1954-1959, kur fill pas vdekjes së Stalinit, në mars të vitit 1953 Hrushovi, që erdhi më krye të PK të dhe shtetit sovjetik filloi një sërë reformash "të cilat synonin të korrigjonin aspekte të vecanta të teorisë dhe praktikës staliniste. "(FESH, 2008, vël. 1, faqe 962), që u sanksionuan në Kongresin e 20-të të PK të Bashkimit Sovjetik, i cili u mbajt në shkurt të vitit 1956 në Moskë.

Ata qenë dëshmtarë të procesit të destalinizimit, pra të luftës kundër kultit të individit të Stalinit, i cili me aparatit e tij të dhunshëm i kishte sjellë shumë mjerime dhe fatkeqësi popujve sovjetikë. Dhe ky proces u shtri dhe në vende të tjera të Lindjes Komuniste, me mënjanimin e e udhëheqësve stalinistë të tyre, (por jo në Shqipëri).

Ata qenë dëshmtarë të rehabilitimit të mijëra njerëzve të pafajshëm që ishin dënuar me burgime dhe internime, të rishikimit të planeve ekonomike duke i kushtuar me shumë rëndësi industrisë së lehtë me pikësnyim shtimin e prodhimit të artikujve ushqimorë







atje në Bashkimin Sovjetik. Por forcat e Sigurimit që kishin rënë në gjurmë të tyre, i kapën, i burgosën dhe "drejtësia", për tradhti të lartë ndaj atdheut, i dënoi me... 25 vjet heqje lirie.

Dhe ja, më 8 korrik të vitit 1978, kur shihnin se Enver Hoxha vazhdonte të ndiqte kursin e tij të shtypjes së dhunshme ndaj popullit dhe për më tepër të vetizolimit të Shqipërisë, pas 16 vitesh të kaluara në burgje dhe kampe përqendrimi, Fadili dhe Vangjeli vendosën të shkruanin letrën, tashmë të famshme, dhe t'ia dërgonin Hysni Kapos, njeriut më të besuar të diktatorit duke shpresuar se udhëheqja komuniste shqiptare do ta mënjanonte Enver Hoxhën që po e "zhyste Shqipërinë në humnerën më të turpshme të historisë" siç vënë ata në dukje në letrën e tyre. Por kjo nuk ndodhi. Përkundrazi, pas një procesi gjyqësor "drejtësia komuniste" e urdhëruar nga lart, i dënoi ata me pushkatim, vendim që u zbatua më 28 maj të vitit 1979.

Kaluan vite e vite. Diktatura komuniste u shemb. Shumë të burgosur politikë, të dënuar gjate periudhës komuniste filluan të rehabilitoheshin. Për ta nisën shkruanin gazetën, të përgatiteshin emisionet nga mediat elektronike. Çuditërisht askush nga drejtuesit e RTVSH-së, pas vitit 1990 nuk u kujtua për gazetarët e pushkatuar, Fadil Kokomani dhe Vangjel Lezho, edhe sot nga gazetarët më të mirë të Radio Tiranës në të gjitha kohët.

...Ishte mëngjesi i 20 majit të vitit 1994, kur hyra në zyrën

e Skënder Buçpapajt, atëherë drejtor i përgjithshëm i RTVSH-së. Dhe jo pa qëllim. I kujtova se më 28 maj mbusheshin 15 vjet nga dita e pushkatimit të Fadil Kokomani dhe Vangjel Lezho, si dhe të Xhelal Koprenckës, një të burgosuri tjetër politik që ishte pushkatuar së bashku me ta. Shtova se pas rënies së diktaturës, ishte rasti që ky përvjetor të përkujtohej me një ceremoni të veçantë.

Njeri i kulturuar, poet dhe publicist i njohur, ai me falenderoi shumë dhe së bashku dhe të nesërmen hartuam edhe planin për organizimin e një mbledhjeje solemne në bashkëpunim me Komitetin e të Përmjekurve Politikë. Dhe kështu u bë.

Ndërkohë, unë së bashku me Pirro Nacen, gazetar dhe radiokronist i njohur në Radio Tirana në vitet 50-60-të, i cili u nda nga jeta më 2006, që të dy ne, shokë të ngushtë të Fadil Kokomani dhe Vangjel Lezho, përgatitëm një kumtesë, që më pas u bë bazë e këtij shkrimi, kushtuar atyre.

Qe një mbledhje prekëse kushtuar këtyre gazetarëve martirë, si dhe shokut të tyre, Xhelal Koprenckës, të cilëve, për qëndrimin e tyre të pamposhtur, mbajtur gjatë 16 vjetëve që kishin kaluar nga viti 1963, deri në ditën e pushkatimit nëpër burgje dhe kampe përqendrimi, në atë ceremoni nga Presidiumi i Kuvendit Popullor iu dha dekorata "Martirë të Demokracisë".

Vec kësaj, si Radio Tirana, ashtu

edhe RTSH-ja, përgatitën emisione të posaçme kushtuar atyre. Me këtë rast edhe unë botova gjithashtu një artikull të gjatë në gazetën "RD".

#### CILËT ISHIN FADIL KOKOMANI DHE VANGJEL LEZHO?

"I nderuar koleg gjykues,

Xixëllonjës netëve të bukura të verës i duket sikur ndriçon gjithësinë me dritëzën e saj: në të vërtetë nuk ndrit dot as edhe një fije bari. E njejtja gjë ndodhi dhe me aktakuzën e këtij procesi gjyqësor. Ajo u venit... Xhirimi si në film i tërë skenave hetimore solli këtu përpara jush dy dosje të mëdha, të fryra e të potershme, që, po t'i redaktosh, u mbetet vetëm ajo për të cilën u dënuam bashkë me Vangjelin..."

Sikur të mos e dija që këto reshta janë shkëputur, nga njeri prej proceseve gjyqësore më tragjike dhe më tronditëse që janë zhvilluar ndonjëherë gjatë regjimit të tmerrshëm komunist në vendin tonë, (17 maj 1979), do të gjykoja që ndonjë shkrimtar i talentuar ka arritur të vërë në gojë e njeri prej personazheve të tij të burgosur fjalë kaq prekëse.

Por, në fakt, nuk është aspak kështu.

Në këtë rast, si edhe në raste të tjera që do t'u paraqes lexuesve të këtij dosieri nuk ka punuar kursesi fantazia e ndonjë shkrimtari për t'ia pasur zili. Ato radhë i ka shkruar në një nga qelitë e Burgut të Ri të Tiranës i burgosuri politik, Fadil Kokomani, së bashku me shokun e tij, Vangjel Lezho, pasi të dy e dinin se, veç pushkatimit, nuk i priste asgjë tjetër.

Të habit gjakftohtësia, guximi dhe trimëria e këtyre dy të burgosurve, që, edhe në ato caste aq të rënda, jo vetëm shkruan mbi 20 faqe, që përfaqësonin fjalën e tyre të mbrojtjes para trupit gjykues, por edhe i shkruan me frymëzim, talent, me një gjuhë fshikulluese e demaskuese, që i bëri anëtarët e trupit gjykues, sipas dëshmitëve të të pranishmëve në sallën e gjyqit, të mbeteshin të ngrirë e të mos guxonin ta ndërprinin ligjëratën e tyre të madhërishtme.

Ç'kishte ndodhur, përse po zhvillohej ky proces gjyqësor, përse Fadil Kokomani e Vangjel Lezho, të dënuar me nga 25 vjet burg, po ridënoheshin këtë radhë me pushkatim, pasi kishin bërë rreth 16 vjet burgim të rëndë në kampe e përqendrimet. Bashkë me ta edhe Xhelal Koprencka, një tjerër i burgosur politik.

Fadil Kokomani dhe Vangjel Lezho, sic e pamë më sipër, ishin dy shokë që u lidhën me një miqësi shumë të ngushtë gjatë viteve të studimit për gazetari në shkollat e larta të Bashkimit Sovjetik.

Fadili kishte lindur në Durrës më 1933 në një familje me tradita atdhedashëse. Vangjeli kishte lindur një vit më parë në Fier, në një familje të varfër. Fadili kishte mbaruar shkollën e mesme në qytetin e lindjes dhe ishte dërguar të studioje për gazetari në Leningrad. Dy vjet më pas, me të mbaruar shkollën pedagogjike në Elbasan, në Leningrad e shkonte për të njejtat studime edhe Vangjeli. Ja, pra njohja midis tyre, e cila vazhdon e thellohet edhe më shumë, edhe pse Vangjeli, për arsye shëndetësore detyrohet të vazhdojë për gazetari studimet në Moskë.

Kjo miqësi bëhet edhe më e fortë në Tiranë. Fadili, me të mba-

ruar studimet, emërohet më 1957 gazetar në Radio Tirana. Dy vjet më pas po në Radio nis të punojë edhe Vangjeli.

I kam njohur që të dy nga afër. Në një konkurs letrar në UT më 1958 fitova një cmim me një tregim dhe Fadili, që përgatiste "Emisionin e Rinisë", më ftoi në një intervistë. Ishte koha kur sapo kisha nisur të bëja prova për folës në Radio. Dhe ishte Fadili së bashku me folësen e mirënjohur, Vera Zheji, që më nxitën e më dhanë zemër që të punoja me ngulm në mikrofon.

Disi i shkurtër, por me trup të ngjeshur, fytyrë të lëmuar, gjithnjë të qeshur, ku binte në pah hunda e drejtë e sytë e kafenjtë, Fadili ishte po aq gazmor dhe i ciltër, sidomos në biseda, ku menjëherë të bentë për vete, vecanërisht me kulturën e gjerë në fushën e letërsisë dhe të muzikës. Dhe tërë këtë kulturë ai e derdhte në emisionet radiofonike, disa prej të cilave kam pasur rast t'i lexoj si folës në mikrofon. Ato, duhet thënë se qenë të një niveli shumë të lartë artistik, krahas emisioneve të përgatitura nga Pirro Nace, Ymer Minxhozi, Liri Celi, Maqo Afezollu, Kadri Zotria e gazetarë të tjerë të Radio Tiranës.

Edhe Vangjeli, me të nisur punën më 1959 në redaksinë e kulturës, së bashku me Fadilin, dëshmoi se kishte talent. Ai vinte i gjatë, i hajthëm, por i zhdërvjelltë, me fytyrë ezmore, pakëz eshtake, ku përshkënditnin sytë e zinj dhe plot gjallëri.

Të dy ishin nga të parët gazetarë në Radio Tirana, që kishin diplomën e gazetarit, dukuri e rrallë e rrallë deri atëherë në këtë institucion. Të dy ishin po të parët që kërkuan rrugë të reja, për ngritjen e nivelit artistik të emisioneve në Radio, ku kishte ende dobësi.

Kishte dhe një arsye: Ata vinin nga një vend ku niveli i Radios ishte i lartë, sidomos pas Kongresit të 20-të, ku u dënua kulti i individit i Stalinist dhe letërsia, artet e gazetaria patën një hop shumë të madh cilësor. Këtë e vëreja edhe unë, që, ende student i vitit të fundit në UT për gjuhë-letërsi, kisha nisur të lexoja me vemendje shtypin sovjetik.

Mbi të gjitha, në fushën e letërsisë dhe arteve, dhe vecanërisht kinematografisë pas kongresit në fjalë, kishte nisur një luftë e ashpër kundër dogmatizmit, që i cuan ato në nivele të larta botërore. (Kujtoni vetëm novelën "Fati i njeriut" të Shollohovit, që u ekranizua dhe u shfaq me sukses në shumë vende të botës, madje edhe në SHBA, si dhe filmat e tjerë "Shtegtojnë krillat", "Baladë për ushtarin", "I dyzetënjëjti", "Qiell i pastër", etj., që u vlerësuan më cmime në festivale të njohura ndërkombëtare).

Të ndikuar nga këto dukuri të përjetuara gjatë viteve të studimit, Fadil Kokomani dhe Vangjel Lezho sollën kështu shumë të reja në emisionet e tyre, të cilat nuk jemi në gjendje t'i gjykojmë, sepse, duke qenë materiale radiofonike, ato nuk janë ruajtur. Por dihet se Fadili kultivoi me mjeshtri të rrallë, përshkrimin, reportazhin, e mbi të gjitha, "novelat muzikore", kushtuar figurave më të mëdha të muzikës botërore, që pëlqeshin së tepërmi nga dëgjuesit tanë.

Midis tyre më kujtohet edhe një emision shumë interesant që ai së bashku me gazetarin tjetër, Kadri Zotria,...



# Pas 25 vitesh burg

## Pse u ridënuan me pushkatim dy gazetarët e Radio Tiranës

vijon nga faqja 15

.....kushtuar tenorit të madh italian, Tito Skipa. Më 1959, me rastin e festave të nëntorit ai vizitoi vendin tonë dhe, midis të tjerash, u shpreh në mikrofonin e Fadilit se krenohet që kishte origjinë shqiptare, duke u nisur edhe nga mbiemri i tij Skipa, (pra, skip-shqiptar).

Edhe Vangjeli ndiqte rrugën e Fadilit, sidomos në emisionet për fëmijë. Është e rëndësishme të theksoj se që të dy gjetën mbështetjen dhe përkrahjen e drejtorit të atëhershëm të Radio Tiranës, Petro Kito, dhe zëvendësit të tij, Ymer Minxhozi, të cilët i cmonin për nivelin artistik dhe pjekurinë profesionale.

Por në janar të vitit 1961 drejtor i Radio Tiranës u emërua Thanas Nano, ish-drejtor i Agjencisë Telegrafike Shqiptare, e më pas zv. drejtor i drejtorisë së propagandës në Komitetin Qendror të PPSH-së, njeri i vrazhdë, i ftohtë pedant dhe konservator. Ishte periudha kur pas mbledhjes së Moskës të 81 partive, në nëntor të vitit 1960, Enver Hoxha, për të ruajtur fronin "perandorak", u shkëput nga Bashkimi Sovjetik.

Pas një periudhe liberalizmi, që u shfaq edhe në letërsinë, artet tona, dhe madje edhe në gazetari, pra, edhe në programet e Radio Tiranës, dalëngadalë nisi një censurë ndaj cdo risie që në Radio u frenua me shumë zell nga Thanas Nano.

Megjithatë, në këtë periudhë Fadil Kokomani shkroi përshkrimin "Shungullon lugu i Malësisë" që la mbresë të dëgjuesit, u transmetua dhe u ritransmetua dhe madje u cmua edhe në një konkurs të radiove të vendeve të lindjes.

Ishte përsëri Fadili në këtë periudhë që nisi rubrikën "Universiteti Popullor i Radios", me emisione të larmëta nga fusha të ndryshme të shkencës, kulturës, artit, që u bë nga programet më të pëlqyeshme të Radio Tiranës, rubrikë që transmetohej cdo të martë e të enjte në orën 20.30-21.00.

Pikërisht në kuadrin e kësaj rubrike ai filloi ciklin "Dukuri të letërsisë botërore të shekullit XX" dhe vazhdoi të shkruante, vec novelave muzikore, edhe emisione të tjera në këtë fushë, sepse muzika ishte pasion tij. Fadili kishte ndjekur një kurs për kanto në Konservatorin e Leningradit dhe vazhdoi edhe një kurs tjetër

**Ç'kishte ndodhur, përse po zhvillohej ky proces gjyqësor, përse Fadil Kokomani e Vangjel Lezho, të dënuar me nga 25 vjet burg, po ridënoheshin këtë radhë me pushkatim, pasi kishin bërë rreth 16 vjet burgim të rëndë në kampet e përqendrimit. Bashkë me ta edhe Xhelal Koprencka, një tjetër i burgosur politik**



► Burgu i Spaçit

në Tiranë me sopranon e njohur Marije Kraja, e cila dëshmonte se ai mund të bëhej tenor i mirë.

Si Fadili, ashtu edhe Vangjeli ishin të dhënë shumë pas letërsisë artistike. Lexonin vazhdimisht rreth 20-30 faqe në ditë. Fadili, përvec rusishtes, që e zotëronte në mënyrë të përkryer, mësoi edhe italishten.

Të dy bashkëpunonin edhe me organe të tjera të shtypit. Penës së tyre u përkasën, për shembull, disa krijime gazetareske, midis të cilave reportazhi "Në kilometrin 10", botuar në revistën "Nëntori", nr. 10, 1961.

Për të kuptuar se c'prirej realiste përshkonte krijimtarinë e tyre, mjafton të citojmë fragmentin e

fundit të këtij përshkrimi:

"Rrugës do të largohet kamioni i fundit me mbeturinat e lëndëve të ndërtimit. E, megjithatë, fasadat do të jenë ende të njoma, dritaret e panumërta me sy të gëzuar e të lumtur do të mbushen plot dritë. Ja, pra, e tillë është tabloja e jetës sonë. Ajo nuk është as simbol, as alegori, as analogji. Ajo duhet kuptuar ashtu sic është...."

Fraza e fundit, "ajo duhet kuptuar sic është" për mendimin tim, me domethënie të qartë, sic duket, u ka shpëtuar redaktorëve. Fadili e Vangjeli, me sa duket, nuk i kishin shkruar rastësisht ato fjalë. Kjo ishte kredoja e tyre. Dhe, po të jetonin, në veprat e tyre do të dinin të zbërthenin më thellë këtë

kredo me talentin e tyre që nuk u mungonte, por që vdekja mizore dhe e parakohshme nuk ua la ta shprehnin më gjatë.

Fadil Kokomani, ndërkohë, botoi edhe shkrime në organe të tjera të shtypit. Jo shumë, sepse puna intensive në Radio e pengonte. Por ndër shkrimet e tij po përmend artikujt "Madamë Bateria dhe artistët tanë", ("Zëri i rinisë", 19 prill 1961), "Ludvig Van Beethoven", ("Zëri i Rinisë", 5 korrik 1961), "Në rrugë", ("Zëri i Rinisë", 21 tetor 1961), "Këngëtarët e malësisë", ("Zëri i Popullit", 26 qershor 1960), tregimin "Kënga na bashkoi", "Zëri i Rinisë", 4 mars 1961, dhe krijime të tjera në revistën "Ylli".

Ndonëse shkroi pak tregime,

Fadili tregoi se i kishte të tëra mundësitë të bëhej shkrimtar serioz, sepse, vec të tjerash, kishte gjuhë të rrjedhshme, dialog të shkathët dhe të natyrshëm, forcë përshkruese, që e dëshmon edhe ky fragment nga tregimi "Malësorja e vogël", ("Zëri i Rinisë", 31 maj 1961), të cilin po citoj më poshtë:

"Bulëzat e fundit të vjeshtës, ndërkohë u shkrinë, u tretën njëherësh nga rrezja e parë e diellit mëngjesor, që m'i lëbyri sytë ende të muguëtar.

Shflettoja veprën e Migjenit dhe herë pas here, për t'u këndellur, hidhja vështrimin në thellësi të bjeshkës, ku, mes gurësh të stërmëdhën, që zbardhonin, shfaqej një si njollë e e zezë-



► Vangjel Lezho





► Fadil Kok



► Vangjel Lezhok

shpella e trimave...Qetësia për-reth, pyjet e gjelbëruara ku kishite bredhur poeti, i kredhur në botën e tingujve vrundullues, të tingujve të natyrës magjepsëse, freskia fladitës, sikur më hovëzonin ..."

Fadili gjatë punës në Radio Tirana provoi jo pa sukses të shkruante edhe drama. Në vitin 1962 në emisionin "Teatri në mikrofon" u transmetua një dramë e tij kushtuar atdhetarit të shquar Mihal Grameno. Për fat të keq, as ajo dhe as ndonjë krijim tjetër i tij dhe Vangjelit, pas arrestimit të tyre, nuk u ruajtën në fonotekën e Radio Tiranës.

Të dy shokët e ngushtë jetonin në kushte të vështira. Fadili në një dhomë të ftohtë në Radio dhe Vangjeli në një hotel të mjerrë në qendër të Tiranës, së bashku me gruan, një moskuvite e këndshme, e quajtur Ina, që kishte lindur një fëmijë dhe, sic i kam parë vetë, ndjeheshin tepër ngushtë në atë mjedis.

Për më tepër, e shoqja ishte studente dhe i duhej edhe të të mbante fëmijën, edhe të studionte. Sidoqoftë, të dy ishin optimistë, ashtu si edhe Fadili, i cili, në verë të vitit 1960 priste të shkonte për vizitë në Bashkimin Sovjetik.

Të dy shokët kishin një konceptim shumë realist jo vetëm për letërsinë, por edhe për jetën. Këtë e kuptova kur në gusht të vitit 1959, pas mbarimit të studimeve në UT, u emërova gazetar në Radio. Tashmë isha kolegj me Fadilin dhe më pas edhe me Vangjelin. Dëshira ime ishte të bëhesha gazetar si ata, sidomos si Fadili. Dhe kështu ndodhi. Nisa të ndiqja krijimtarinë e tij dhe të përfitoj nga ajo. Sic do të shohim më poshtë, edhe njohja u bë më e madhe, më e ciltër.

## SI U AFROVA EDHE MË SHUMË ME FADILIN

Nuk harroj shkurtin e vitit 1960, kur mua dhe Fadilin na caktuan të bënim të ashtuquajturën punë fizike në kodrat e Tiranës, aty ku ngrihet Sanatoriumi. Ishte muaji i dytë që kishite nisur të zbatohet kjo metodë kineze, e cila do të shërbentë gjoja për të shkundur e cimpirë administratën që duhej, edhe ajo, të dinte në praktikë se çfarë ishte puna në prodhim.

Gjatë janarit të atij viti punën fizike e kishite kryer as më shumë ë as më pak edhe vetë kryeministri, Mehmet Shehu, për të cilin poeti dhe gazetari i njohur, Dritëro Agolli, kishte botuar edhe një reportazh në "Zërin e Popullit".

Dhe ja, një mëngjes ishim ulur diku në një bregore pranë godinës së Sanatorimit të Tiranës, që ishte në mbarim e sipër, e po hanim ato që kishim marrë me vete. Shtërngoja në dorë një kothere buke të zezë, të qullët, të cilën nga nxitimi nuk kisha mundur ta thekja.

-Ama, c'bukë!-shpërtheu Fadili pa prituri. -Dhe kur, pas kaq vjetësh që shkruajmë e gënjejmë se po ndërtojmë socializmin!

Të them të drejtën, u bevasova. Ishte hera e parë gjatë atyre tre vjetëve që njihesha me Fadilin e nuk kisha dëgjuar kurrë që ai të shprehej në këtë mënyrë, ndaj ia ktheva.:

-C'të bësh, kalojmë po ato vështirësi që ka kaluar Bashkimi Sovjetik në vitet 30-të. Të kujtohet se si shkruan Majakovski në një poemë për atë punëtorin që ngjesh bukën në pëllëmbët e duarve që t'i heqë lagështirën?..

-Të bukur krahasim që po më bën!A e kupton se jemi në vitin 1960?!

Nisi kështu të më fliste më me zemëratë për jetën e rëndë që po kalonim, duke fajësuar drejt-përdrejt Enver Hoxhën dhe ata që e rrethonin. U vura në pozitë të vështirë. Fadili rridhte nga një

familje komuniste. Vec kësaj, një vëlla e kishte oficer madhor.

Ai nuk reshti. Shtoi se në një vend si Shqipëria, ku sundonte diktatura, jeta do të bëhej edhe më e vështirë, sepse vendi po kthehej në burg të madh. Kurse në Bashkimin Sovjetik, pas vdekjes së Stalinit, punët po shkonin krejt ndryshe.

Dhe të tëra këto ai po i shqiptonte me bindje, kur marrëdhëniet me Bashkimin Sovjetik ishin ende shumë të mira, kur gjashtë muaj më parë, në qershor të vitit 1959, Hrushovi kishte vizituar Shqipërinë dhe ishte prituri si perëndi edhe nga vetë Enver Hoxha.

E vërteta është se babai dhe xhaxhi im, menjëherë pas largimit të misioneve anglo-amerikane nga vendi ynë, në vitin 1946, mbetën të zhgënjyer. Të dy, si dhe shumë e shumë të tjerë, kishin prituri që Shqipëria të kishte marrëdhënie si me Perendimin, ashtu edhe me Lindjen. Vec kësaj, që ajo të kishte një qeveri demokratike, të dalë nga zgjedhje të lira, pluraliste. Por ja që tani vendi ynë po lidhej pas qerres jugosllave, për të rënë pastaj plotësisht nën sferën komuniste ruse.

Sidomos këtë e ndiente edhe më shumë xhaxhai im, Reshat Këllici, i cili së bashku me figura të tilla të njohura, si Sejfulla Maleshova, Tajar Zavalani, Llazar Fundo etj, pas kthimit të Zogut, që kishte rrezuar qeverinë e kryesuar nga Fan Noli, ishin detyruar të linin Shqipërinë, për t'u vendosur në B. Sovjetik.

Xhaxhai im që kishte mbaruar atje edhe studimet e larta, kishte kaluar një jetë të vështirë dhe ishte kthyer në atdhe, i zhgënjyer nga ky vend ku... po ndërtohej socializmi stalinist, kishte përjetuar, vec të tjerash, dhunën e tmerrshme që ushtrohej mbi popullin sovjetik me të ashtuquajturën luftë klasash, me përndjekjet nga KGB-ja, (Sigurimi sovjetik), burgimet, internimet, dhe

për këto edhe në praninë time, ndonëse isha ende i vogël, kishte biseduar shpesh edhe me babain tim.

Jo vetmkaq:gjatë atyre viteve të kaluara në Moskë, ai ishte martuar me një ruse. Kur ishte larguar përfudimisht nga B. Sovjetik, më 1934, me shumë dhembje kishte lënë atje një djalë katërvjecar, me shpresë se një ditë do ta shihte përsëri.

Dhe ja kjo ditë erdhi. Selim Shpuza, shoku i tij i viteve studentore në Rusi, më 1945 ishte emëruar sekretar i ambasadës sonë në këtë vend. Atëherë xhaxhai e kishte porositur që të bënte c'shtë e mundur që të gjente ish-gruan e tij dhe djalin, që tashmë duhej të ishte 14 vjec.

Dhe Selim Shpuza kishte premtuar. Por më kot. Me gjithë përpjekjet e tij, autoritetet shtetërore dhe KGB-ja... nuk kishin mundur të gjenin se ku ndodhej ish-gruaja e tij së bashku me djalin.

Cfarë drame!... Me siguri të dy, nënë e bir, kishin përfunduar në ndonjë qytet të humbur siberian, ose përmë keq, në ndonjë kamp përqendrimi. Po përse? Mos ndoshta sepse ishte ajo martuar me një emigrant shqiptar që kishte lënë pastaj Bashkimin Sovjetik?..

Nuk harroj atë ditë, aty nga fundi vitit 1946, kur misionet anglo-amerikane po largoheshin përfundimisht ga Shqipëria, xhaxhai u shpreh kështu:"Tani në Shqipëri do të ndodhë ajo që kam parë për gati nëntë vjet në Rusi. Edhe më shumë dhunë, shtypje, mjerim. Të gjitha në emër të idealave komuniste."

Që atëherë familja dhe të afërmit tanë filluan ta urrenin Bashkimin Sovjetik dhe Stalinin, që, me ato mustaqet e ij të mëdha mua më dukej atëherë aq babaxhan.

Mirëpo, sic e pamë pas vdekjes së Stalinit dhe ardhjes së Hrushonit në fuqi, në këtë vend

filloi një kurs ri, që hodhi poshtë kultin e individit të Stalinit dhe nën parrullën e bashkekzistencës paqësore, zhdukjen e luftës së ftohtë, përmirësimin e marrëdhënieve miqësore me vende të tjera perendimore, sidomos me SHBA-në dhe Britaninë e Madhe, zbutjen e luftës së klasave, rehabilitimin e mijëra njerëzve të dënuar nga diktatura staliniste, etj.

Atëherë xhaxhai me babain dhe të afërmit të tjerë, filluam t'i shihnim më miradijë këto ndryshime që po ndodhnin në Bashkimin Sovjetik, duke shpresuar se edhe Enver Hoxha do të ndiqte të njëjtin shembull. Por, fatkeqësisht, kjo nuk ndodhi.

Ja përse disa javë pas bisedës që kishim bërë gjatë punës fizike në shkurt të vitit 1960, dhe gjatë ditëve të tjera, i kujtova Fadilit ato që më kishte rrëfyer xhaxhai për jetën e tij dhe tmerret që kishte parë në atë vend.

-Për të tilla ngjarje tragjike, -më tha Fadili, kur shetitnm një ditë në Parkun e madh, - më kanë folur jo rrrallë shokë të mi, studentë sovjetikë. Por në Shqipëri do të ndodhë edhe më keq se c'po ndodh tani. -Mbase do të ndodhë që të prishemi me Bashkimin Sovjetik dhe të mbetemi të vecuar nga bota mbarë.

Ato ditë dhe më pas, isha i pushtuar nga një ndjenjë e thellë krenarie: një gazetar, që ishte pesë vjet më i madh se unë, (ai 27 dhe unë 22), për më tepër, edhe më i zoti se unë, më ishte hapur aq ciltërsisht. Kështu po i hapësja edhe unë atij. Dhe atëbotë nisa ta doja edhe më shumë atë që deri atëherë e çmoja si mësues në fushën gazetarisë. Që atëherë, gjithashtu, midis meje, e më pas edhe Vangjelit, nuk kishte të fshehta për çështje politike.

Më pas ndodhi ajo që kishte parashikuar Fadili...



VEPRA | SHKRIMTARI

# Arif Gjyli

## Përshtatësi i parë i Eposit të Kreshnikëve

NGA XHAHID BUSHATI

Shkrimtari Arif Gjyli vdiq, më 23 shtator në moshën 76 vjeçare, në Tiranë. Emri dhe veprimtaria e tij e luftës dhe ajo letrare u kujtuan vetëm nëpërmjet një shkrimi. Më vonë, koha vërtetoi se, ky shkrim-kujtimi ishte i fundit, por jo përmendja e emrit, e kontributit të tij si mësues e didakt (nga të parët që u mor gjerësisht e me hollësi me problemin e mprehtë të teksteve të leximit dhe të letërsisë për fëmijë), krijues e studiues (ka meritën për vënien në pah për të parën herë, të figurës së poetit popullor tiranas Zenel Bastari dhe të një vlerësimi poetik - analitik të jetës dhe problematikës së veprës të Migjenit).

Si krijues, Arif Gjyli la "gjurmën" e tij në fushën e letrave për fëmijë e të rinj. Konfiguracioni i kësaj "gjurme" ka dhe mbart në thelbin e saj, modelin e një krijuesi që përvetësoi disa tipare, si: idealin, përkushtimin dhe natyrën që e kishin rilindësit tanë të shquar e të ditur që, mesa duket, ia mëkuan me dashuri edhe intelektualit Arif Gjyli. Duke përqafuar atë model, ai ndoqi atë rrugë të ndritur; u mor dhe dha ndihmesë në fushën e letërsisë shqipe për fëmijë e të rinj e më gjerë (pedagogji, psikologji, mësuesi), kuptohet në një kontekst të ri historik, i cili shpërfaqte dita-ditës dukuri të reja në jetën shoqërore e kulturore.

Arif Gjylin nuk e kam takuar qoftë edhe një herë në jetë, ndonëse emri i tij ishte i "shëtitur" në Shkodër. Nuk pata rast ta njoh personalisht dhe të bisedoj me të, ndonëse kam pasur shumë dëshirë... Së paku, t'i bëja një portret sa njerëzor aq dhe artistik. Pas shumë vitesh, gjeta si relikte të çmueshme, disa grimca të portretit të tij në librin "Muhamet Uruçi, babai im". Në pjesën e titulluar: "Në vend të hyrjes" të këtij libri memuaristik, citoj: "Ka një memorie të jashtëzakonshme... ka mbetur si gjithmonë i ndershëm." Gjithashtu citoj: "Më shikoi drejtpërsëdrejti dhe unë për herë të parë dallova nën xhamat e tejdukshëm një palë sy plot dritë."; ... "Pas kaq vitesh mund të them se takimi me Arif Gjylin më ka lënë një shije shumë të ëmbël, jo vetëm për kulturën e gjithanshme që rrezatonte, por edhe për saktësinë me të cilën ai kujtonte dhe njihte gjithçka me detaje nga ato vite të vështira."

Edhe pse kanë kaluar disa dekada nga çlirimi i Shqipërisë, Arif Gjyli nuk është i shpëputur nga kujtimet e luftës, që për të në thelb, ato, duhet të ishin realizueset e ëndrrave të tij të vërteta. Për ato ëndrra, ai la peng jetën. Siç duket për Arif Gjylin, një pjesë mbeten vetëm ëndrra... Ata merrnin 'jetë' vetëm kur ai i kujtonte (herëpashere) nëpërmjet bisedës

**Optikë rileximi për librin "Trimat e Jutbinës" të shkrimtarit Arif Gjyli, vepër që jeton dhe sot sepse autori i ruajti hapësirat e Jutbinës. I njohu mirë dhe i dashuroi. Ashtu siç i përftoi me ndjesinë e shkrimtarit, ashtu edhe i dhuroi si "Jutbinë" krijimtarie...**



së tij të heshtur për plagët e luftës dhe përmendjes së emrave të shokëve të vërtetë. Ishte një bisedë e dhembshur dhe tragjike. Kujtonte edhe momente si këto: "Më mbanin të lidhur me tela, më kanë mbajtur pa gjumë, më kanë mbajtur për një kohë të gjatë në çimento... Natën më linin pa gjumë dhe gjithë ditën i binin një gramafoni të madh shurdhues sa të mos mundja që të fle asnjë minutë. ... Më morën e më shoqëruan në një pyll aty pranë. Në këtë kohë unë fillova të dyshoja dhe fillova të bërtas. ... Më bënë një gropë në formë varri dhe më

kërcënuan se do të më vrisnin si buharinist. Pastaj më sollën me automobil këtej tek Tirana e re. Më vonë e pashë se më kishin çuar në një shtëpi në rrugën e Elbasanit. Në këtë shtëpi më mbajtën 43 ditë mes torturave ç'njerëzore."

Marrëdhënia e krijuesit Arif Gjyli me letërsinë shqipe për fëmijë e të rinj janë objekt i këtij shkrimi. Përmes këtyre rreshtave kërkoj një shikim ndryshe, një optikë rivlerësimi veçanërisht në dialog me kohën e pas kohën që jetoi e krijoi ky shkrimtar. Librat e botuar, duke parë vitet përkatëse të botimit, nuk përkojnë me fillimet e

vërteta të ndihmesës së Arif Gjylit në fushën e letërsisë shqipe për fëmijë e të rinj. Vitet e "ndajnë" dhe e "largojnë" nga fillimet dhe të vërtetat letrare. Arsyes... sikur mbeten të pakuptueshme, nganjëherë absurde.

Si krijues, fakt, i takon brezit të shkrimtarëve që krijuan traditën e re të letërsisë shqipe për fëmijë e të rinj. Si krijues vetëm emri i përmendët. Në të rrallë edhe nja dy gisht rreshta. Kur në të vërtetë ai dhe brezi i tij: "... zgjeruan shumë diapazonin tematik, që thelluan fondin realist dhe që e ngritën në një nivel më të lartë cilësinë ideoartistike...". ... Më tej, po për këtë shkrimtar thuhet ... "Në këtë kuadër, gjithashtu, duhet parë edhe kontributi i shkrimtarëve më me stazh si M. Kuteli, Arif Gjyli, M. Zaloshnja, që bënë një punë të mirë për popullarizimin e letërsisë së pasur të popullit për fëmijë, ose përmes ritregimit, në formë të përshtatshme, të rapsodive dhe baladave të moçme shqiptare, ose përmes përpunimit të përrallave popullore dhe tregimeve të tjera të kësaj natyre. Në traditën e re hyn edhe kriteri i vlerësimit, tek i cili u mbështetën shkrimtarët B. Dedja, M. Gurakuqi, Arif Gjyli, M. Zaloshnja dhe N. Jorgaqi për të mbledhur dhe redaktuar vepra të disa autorëve të shquar të së kaluarës për fëmijë". Dhe për të vijuar mendimin e mësipërm, me atë që një studiues tjetër e quan absorbim të folklorit, gjejmë nga ai këtë formulim, formulim që gjen mbështetje në marrëdhëniet të ndërsjellë të krijimit letrar dhe folklorit: "Një pjesë shumë e konsiderueshme e vjershave me subjekt ose e poemave të De Radës, Darës, Serembes, Sakos, Çaçit, Jakovës, Siliqit, Balës, Qafëzezit, Çomorës, Gjylit e më vonë akoma Agollit, Kadaresë, Arapit, Dedes, Beqarajt e Gjokutajt, dëshmojnë për lidhjet e qëndrueshme të poezisë sonë për fëmijë me folklorin, për absorbimin që i kanë bërë të gjithë këta poetë folklorit për nevojën e përhershme që ata kanë ndier për t'u dhënë fëmijëve të brezave të ndryshëm vargje, ku njomështia dhe shpirti popullor të ndihen me po atë forcë që i ka edhe populli".

Në mes shumë studiuesve, gjykimet dhe interpretimet e Prof. Vehbi Balës për këtë model krijuesi, sikur kanë hyrë më në thellësi të procesit krijues të tij, gjë që kanë sjellë më njohje dhe interpretim të veprës letrare. Mendoj se edhe



sot, ata janë aktuale në shikimin dhe zberthimin e figurës së Arif Gjylit në këtë lëmë letrar, lëmë që mbart vlera bashkëjetuese e bashkudhëtuese. Kjo është arsyeja që, studiuesi i mirënjohur i Letërsisë për fëmijë dhe të rinj Prof. as. Dr. Astrit Bishqemi në veprën e tij, me të drejtë ndihmesën letrare si parësore të shkrimtarit Arif Gjyli e vendos të kapitulli "Përshtatja dhe rikrijimi", ku e pozicionon vlerësueshëm dhe meritueshëm, duke e lidhur emrin e tij me lëvrimin e këtyre dy zhanreve (veçanërisht me të parin), qëllimi i të cilit, (dhe të tjerëve krijues që u morën me këto dy zhanre) është: "... që ta bëjnë të kuptueshme e të këndshme për lexuesin e vogël një krijim madhor të folklorit ose një vepër të shquar të letërsisë për të rriturit".

Hulumtimet tona për këtë figurë që, (shkëlqimi, denigrimi dhe heshtja jetuan brenda shpirtit dhe jetës së tij të ndershme) si brez i parë që krijuan traditën e re të letërsisë shqipe për fëmijë, na flasin se në periudha të ndryshme kohore studiuesit, kur kanë dhënë mendime për veprat e Arif Gjylit, pothuaj vëmendjen e kanë përqendruar më shumë te libri "Trimat e Jutbinës". Ky interesim, mendoj, se duhet pranuar.

Nga një vështrim i hedhur në rrafshin historik të procesit të zhvillimit të kësaj letërsie, emri i Arif Gjylit i takon të jetë nga të parët që lëvron përshtatjen dhe rikrijimin, këto dy zhanre, që ende përbëjnë një traditë të re botimi në Shqipëri. Mendimi im përkon me atë të një poeti të mirënjohur, i cili thotë: "Është meritë e Arif Gjylit që, me veprën e tij më të mirë "Trimat e Jutbinës", nisi nga të parët traditën e rrëfimeve të shkruara në bazë të ciklit tonë të mrekullueshëm të kreshnikëve, ...". Ndërsa për dy veprat e tjera të këtij autori: "Historia e dhelprnës plakë". dhe "Djathtas, majtas 1, 2, 3", janë më në periferi nga ana e kritikës sonë letrare. Edhe atëherë kur është dhënë mendimi për to, më





shumë ka ngjasuar me ato rrezet e vagëluara të diellit vjeshtak, që ndoshta kishin nisur t'i përjetonte pak e pak trishtueshëm edhe vetë shkrimtari, jeta dhe koha e të cilit, dikur ishte ëndërrimtare... Për librin "Djathtas, majtas 1, 2, 3" mund të themi se disa nga poezitë e kësaj veprë poetike zgjojnë interes pranimit në tekste shkollore e antologji.

Me të drejtë, nga disa studiues të kohës, është thënë se, "Trimat e Jutbinës" është vepra më e arrirë artistikisht e shkrimtarit Arif Gjyli. Kjo veprë zgjoi dhe interes diskutimi për kohën kur u botua.

Sipas studiueses dhe bibliografe Faire Tabaku kjo veprë shfaq disa marrëdhënie e disa rrafshet vlerash. Në mënyrë të përmbledhur autorja e shkrimit nënvizonte këto: \*Libri "Trimat e Jutbinës" i A. Gjylit doli në qarkullim në tremujorin e fundit të vitit 1960.

\*Brendia e tij është vetë Eposi popullor, janë rapsoditë e Veriut, këngët e bukura të kreshnikëve që populli ynë i ka përcjellë gojë më gojë gjatë shekujve.

\*Fëmijët i kanë shumë qejf veprat fantastike dhe me aventura, ... Ja, pra, pse libri "Trimat e Jutbinës" u bë i dashur për fëmijët.

\*Suksesi i librit qëndron në subjektin e tij.

\*Burimi kryesor i librit është Eposi i Veriut. A. Gjyli ka ditur të zgjedhë disa nga më të bukurat, që u përshtatën më tepër veçorive të moshës së fëmijëve, që janë më afër psikologjisë së tyre.

\*A. Gjyli për të shkruar librin "Trimat e Jutbinës" është mbështetur në dy botime "Visaret e Kombit" 1937 dhe "Këngët popullore legjendare" 1955.

\*Në këto tregime mëshihet dëshira për pamvarësi. (Jutbina bëhet simbolikë e trimërisë, e lirisë, e vlera dhe e virtyteve të shqiptarëve, - nënvizimi im Xh. B.).

\*Në tregimet paraqiten qartë dhe në mënyrë të gjallë të gjitha karakteristikat e shqiptarit, si: besa e Zanave e Orëve dhe e kreshnikëve, trimëria dhe burrëria

e tyre..., besë - tytnitë e popullit tonë; d o k e t , m i k u , dashuria dhe nderi i familjes, trimëria, etj.

\*Vetë A. Gjyli thotë se duke u dhënë për botim këtë libër është nisur nga dëshira që t'u bëjë të njohur fëmijëve disa nga rapsoditë e bukura të Veriut, t'i përgatisë ato që t'i shijojnë në origjinal.

Duke mos iu larguar problemit që po trajtojmë rreth krijimtarisë së shkrimtarit Arif Gjyli, një studiues që e njeh mirë veprën e këtij autori, thotë se: "Aspekti i veçantë i mbështetjes së shkrimtarëve të folklorit ishte, ndër të tjera, përshtatja për të vegjlit e pjesëve nga cikli i kreshnikëve. Disa nga këngët më të bukura të rapsodive të Veriut përfshihen në librin "Trimat e Jutbinës" (1959) e A. Gjylit. Autori i mbledhi dhe i përpunoi ato me kujdes, duke ruajtur vlerat origjinale të tyre. ... Gjatë përpunimit të motiveve, autori ka ruajtur veçoritë e ligjërit popullor, si përdorimin e fjalive të shkurtra e të ngjeshura me mendim, përforsimin e ideve dhe të veçorive të personazheve me anë të përsëritjes dhe të rimarrjes së situatave, përzgjedhjen e shprehjeve dhe të figurave karakteristike për krijimtarinë gojore të popullit, etj. Mirëpo, përshtatja në prozë e

kohëve të ndryshme".

\*"... në Këngët kreshnike gjithëçka është e mundshme, ngase e thëna bazohet në mrekullitaren dhe në fantastiken".

\*"Këto këngë, prandaj, e japin ndodhinë, apo ngjarjen të figuruar, nëpërmjet një procesi krijues të tregimit, përshkrimit dhe sigurimit". (gjithashtu nënkupto dhe "Trimat e Jutbinës").

Vepra jeton dhe sot. Kjo është vlerë e veprës. Për arsye se, autori i ruajti hapësirat e Jutbinës. I njohu mirë dhe i dashuroi. Ashtu siç i përftoi me ndjesinë e shkrimtarit, ashtu edhe i dhuroi si "Jutbinë" krijimtarie. Mbi këtë bazë, optika e sotme e rileximit na thotë se, vepra e Arif Gjylit i mbarti dhe i ruajti vlerat përmes një fenomeni të njohur, siç ishte ai i marrëdhënies mes letërsisë së shkruar shqiptare dhe folklorit e letërsisë gojore, (ekuilibër që e ruajti artistikisht si në formë, strukturë e veçanërisht në përmbajtje, - nënvizimi im Xh.B). Në mënyrën e perceptimit dhe të paraqitjes në shtjellimin artistik, ashtu siç e theksuam më lart, shkrimtari preferoi përshtatjen.

Vepra "Trimat e Jutbinës" ka shenjen dhe koherencën e saj. Nocioni kohor, nocion që shoqëron veprën mbetet një marrëdhënie që duhet parë e studiuar. Për këtë problem studiuesi Jorgo Bullo thotë: "Në qoftë se me "Tregimet e moçme shqiptare" M. Kuteli, duke çelur rrugë në prozë, ritregoi me një ndjenjë të holle artistike subjektet dramatike të këngëve të ciklit heroik dhe legjendar, stilizimet e disa prej tyre dhe motive të shkëputura formojnë bazën e subjekteve të shumë krijimeve në prozë, sidomos për të vegjël, por edhe për të rritur. Rëndësia e këtyre krijimeve (të N. Priftit, A. Gjylit, M. Zeqos etj. ) qëndron në radhë të parë në popullarizimin e traditës folklorike dhe në pohimin e mundësive të saj për të ushqyer zhvillimin e prozës së re me subjekte dhe ide

që e ruajnë aktualitetin edhe në kohën tonë dhe i shërbejnë edukimit të brezit të ri me virtyte morale të trashëguara nga të parët edhe përmes folklorit.

Por, ndërmjet kësaj mënyre të shfrytëzimit të motiveve të eposit heroik, që u mbetet besnike subjekteve tradicionale dhe mënyrës tjetër, ku subjektet folklorike shërbejnë vetëm si pikënisje për të ndërtuar një ngrehinë të re artistike, qëndron një mënyrë e tretë, ajo e integritimit të motiveve të ndryshme të këngëve të eposit në subjekte që s'kanë asnjë lidhje me kontekstin social-historik të ciklit, të cilit i përkasin ato motive.

Në optikën tonë të rileximeve sollëm në kujtesë veprën "Trimat e Jutbinës" të shkrimtarit Arif Gjyli, edhe për një arsye tjetër, se "Brezave të rinj ai do të vazhdojë

t'u rrefejë për "Trimat e Jutbinës". Si gjysh i mirë ai do t'u tregojë vogëlushëve "Historinë e dheltnës plakë", kurse në përmbledhjen me vjersha për fëmijë "Djathtas, majtas 1, 2, 3!" do t'u flasë për stinët e bukura të Atdheut tonë të shtrenjtë, ...".

Shkodër, maj 2019

## LITERATURA E SHFRYTËZUAR:

- Siliqi, Llazar: "Me mendjen te brezat e rinj", Drita, 01.10.1989

- Uruçi, Dashamir: "Muhamet Uruçi, babai im", Geer, Tiranë, 2011.

- Po aty, f. 23., thënie e Xhavit Gjylbegajt, mjek pediatër. Ishte ky, Piciruku i famshëm që u bë burim frymëzimi për veprën me të njëjtin emër të shkrimtarit Teufik Gjyli.

- Dëshmia e ish-deputetit Arif Gjyli, botuar në gazetën Dita, 14. 05. 2013.

- Gjyli, Arif botoi këto libra: "Historia e dheltnës plakë" (përrallë në vargje, Naim Frashëri, Tiranë, 1958), "Trimat e Jutbinës" (punue simbas motiveve popullore, Naim Frashëri, Tiranë, 1959), "Djathtas, majtas 1, 2, 3", Naim Frashëri, Tiranë, 1960), "Trimëria e burrërisë". Naim Frashëri, Tiranë, 1964 (përzgjedhje nga tekstet e këndimeve të përdorura deri në vitin 1927).

- Simpoziumi i parë kombëtar për problemet e letërsisë për fëmijë" (27 - 28 maj 1974), Naim Frashëri, Tiranë, 1975; shkrimi: "Probleme të studimit të traditës së re të letërsisë sonë të sotme për fëmijë" autori: Prof. Vehbi Bala, f. 38.

- "Probleme të traditës dhe të aktualitetit në letërsinë tonë për fëmijë", Naim Frashëri, Tiranë, 1976; Adriatik Kallulli: "Poezia jonë për fëmijë dhe folklori", f. 117.

- Bishqemi, Prof. As. Dr. Astrit: "Historia e letërsisë shqiptare për fëmijë e të rinj" (kapitulli: Përshtatja dhe rikrijimi), 4.2.2.3.6, f. 537 - 538, Botim i tretë, i plotësuar dhe i përmirësuar, dy Lindjes dhe dy Perëndime, Tiranë, 2008.

- Bibliografia e Letërsisë për fëmijë dhe të rinj (1945 - 1964), përpiluar nga: Faire Tabaku dhe Diana Kosturi, (Instituti i Studimeve dhe Botimeve shkollore, Tiranë, 1965), zëri: 59. Gjyli, A. Historia e dheltnës plakë. (Përralla). (Pikt. V. Lalo), Tiranë, "Naim Frashëri", 1958. 56 f. Me ill. 18 cm. Tir. 3000, L. 15.

- "Anija e çuditshme", vjersha për fatesat, Naim Frashëri, Tiranë, 1962. Në këtë antologji poeti Arif Gjyli përfaqësohet me poezitë: "Unë e babi", "Kukulla Mirushkë e sëmurë", "Rreth e rrotull", "Treni ynë".

- Më 23.04.1961 Komisioni i letërsisë për fëmijë pranë Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve organizoi një diskutim krijues rreth librit "Trimat e Jutbinës" të shkrimtarit Arif Gjyli. Mbi këtë veprë foli Faire Tabaku, përgjegjëse e bibliotekës për fëmijë të Pallatit të pionierëve në Tiranë.

- Çadri, Prof. As. Dr. Ramazan: "Lindja dhe formimi i Letërsisë shqipe për fëmijë", Redona, Tiranë, 2009, ( Nga pjesa 1.1. Fillimet e përrallës së re për fëmijë, F. 113 - 114).

- Hamiti, Sabri: "Albanizma", Botues: Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Botime të veçanta CIII, Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Libri 42, Prishtinë, 2009; (Letërsia Monumentale, 2. Monumentet: Historia, Kanuni, Kanga), f. 62.

- Bullo, Jorgo: "Magjia dhe magjistarët e fjalës", Dituria, Tiranë, 1998, shkrimi: "Eposi legjendar në prozë e sotme", f. 99.





# Ngjarja e rrallë, një pako me florinj në postën e Tiranës

**Historia e një pakoje të nisur nga Posta e Triestes, që adresohet për në Greqi. Si erdhi në Tiranë dhe çfarë ndodhi me të...**

NGA **FREDERIK STAMATI**

**K**jo ndodhi në vitin një mijë e nëntëqind e tridhjetë e ca. Nuk e di mirë. Kur ma tregoi im atë, Micenkoja, isha i vogël, në atë moshë kur interesi përqëndrohet te topi dhe lojrat dhe jo në ngjarje që ledhatojnë shpirtin. Ka vite, me dhjetra, që im atë nuk është më dhe ndoshta vetëm rasti, apo kërkimi me një vështirësi

absolute në arkiva do të mundet të përcaktojë vitin, gjë që nuk e shpresoj.

Babai im punonte në postën e Tiranës, herë-herë edhe në sektorin e kolipoistës, që merret me pakot që vijnë nga jashtë.

Një mbasdite, kur po sistemonte koltitë e ardhura, nga njëra pako e dëmtuar në cep, "rodhën" disa monedha prej ari...

Lexoi destinacionin. Pakoja ishte nisur nga Posta e Triestes dhe adresohet për në Greqi. Ajo erdhi gabimisht në Tiranë. Baba

lajmëroi menjëherë drejtorin. E hapën pakon. E gjitha ishte mbushur me monedha ari. Sa? Shumë.

U bë menjëherë inventari dhe u lajmërua Posta e Triestes, e cila konfirmoi dërgesën, që për ndonjë pakujdesi kishte "ndrruar rrugën" dhe erdhi në Tiranë.

Posta shqiptare e ktheu pakon së bashku me florinj të brenda në destinacionin nga ishte nisur, ndërsa Posta e Triestes dërgoi një letër falenderimi për gjestin, ku baba im ishte autori.



▶ Ne foto, baba i autorit, Micenko Stamat

## LIBRI

Mira Meksi, sjell nga origjinali në shqip "Njëqind vjet vetmi" të Markesit

**100** vjet vetmi" ("Cien años de soledad"), kryevepra e krijimtarisë së Markesit, e përkthyer shumë vite më parë shqip nga Robert Shvarc, këtë herë përkthehet nga gjuha burimore. Romani, që ka shënuar kulmin e realizmit magjik vjen i përkthyer spanjishtja në shqip nga Mira Meksi.

Shtëpia botuese "Onufri" njofton hedhjen në treg të romanit, duke kujtuar fjalët me të cilat nis vepra: "Shumë vjet më vonë, përballë togës së pushkatimit, kolonel Aureliano Buendía-s do t'i kujtohej ajo pasdite e largët, kur i ati e çoi të shihte akullin...".

Në faqet e këtij romani shpaloset një nga aventurat letrare më të jashtëzakonshme të shekullit XX. Familja Buendía-Iguarán, me mrekullitë e saj, fantazitë, idengulitjet, tragjeditë, incestet, kurorëshkeljet, rebelimet, zbulimet dhe dënimet, paraqet njëkohshëm mitin dhe historinë, tragjedinë dhe dashurinë e gjithë botës.

Historia e librit më të famshëm të Gabriel Garcia Markesit fillon në mars të vitit 1952 gjatë një udhëtimi



▶ Përkthyesja Mira Meksi


me nënën në Aracataca, fshati i tij i lindjes. Ndoshta pikërisht në ato ditë Ma-

condo filloi të marrë jetë në mendjen e shkrimtarit. Hija e gjyshit, figura më e rëndësishme e jetës së Marquez-it, e ndihmoi të mbyllej me fantazmat e shtëpisë ku kishte jetuar në fëmijëri, për të krijuar botën e tij magjike.

Në romanin "Njëqind vjet vetmi" përshkruhet ngritja dhe rënia e familjes Buendía dhe e fshatit Macondo, themeluar prej kësaj familjeje në zemrën e Kolumbisë. Gjashtë breza, jetët e të cilëve gërshetohen në një dimension alternativ, në një vend jashtë botës. Nga

kryeplaku i familjes dhe themeluesi i Macondo-s, José Arcadio Buendía deri tek fëmija i fundit me të cilin mbyllet romani kalon një shekull, një shekull plot magji dhe misticizëm. Duke u martuar José Arcadio me kushërirën e tij Ursula, të gjashta brezat jetojnë të mbytur nga supersticioni dhe nga frika e fëmijëve me bisht derrkuci. Të pakta janë çastet e lumtura në jetën e Macondo-s, shpesh i trazuar nga lufta civile, lulëzimi ekonomik, shfrytëzimi, katastrofat natyrore dhe shkatërrimet nga dora e njeriut. Jeta që zhvillohet në faqet e romanit nuk është vetëm ajo e fshatit por e gjithë Amerikës Latine. Personazhet e historisë janë të shumtë: nipër, fëmijë, vëllezër, me hidhërimet e tyre, ndryshimet e gjeneratave, fantazitë e papërbushura, vitalitetin e burrave dhe mençurinë e grave të Macondos. Derisa arrijmë në fund, ku tërë fshati shkatërron nga një ciklon tropikal.

Mesazhet e autorit në "Njëqind vjet vetmi" janë të shumta. Marquez na dëshmon që vetmia e ndjek njeriun hap



▶ Gabriel Garcia Marques

pas hapi; një njeri që lufton për mos arritur pastaj në asgjë, për t'u gjetur sërish në pikënisje. Koha përsëritet, faktet gjithashtu, duke dhënë jetë akteret e degjeneruara të personazheve pengojnë çdo përmirësim. Ngjarjet e ndërthurura mes reales dhe fantazisë, mes të vërtetës dhe legjendës zhvillohen

në Macondo, një vend i haruar nga bota. Me këtë veprë Gabriel Garcia Marquez u konsiderua si një pararendës i realizmit magjik në letërsinë latino-amerikane dhe atë botërore të '900-s. Dhe falë mjeshtërisë së stilit, ai ka fituar çmimin Nobel për letërsinë në vitin 1982.

**DHU. HA.**





Parlamenti, 1925



Shtator 1928

## NJE PLLAKE PERKUJTIMORE PER PARLAMENTIN E PARE SHQIPTAR

QERIM VRIONI  
TIRANE

Disa vite më parë shoqëroja një mik italian nëpër Vlorë, sidomos në pikat simbol të qytetit. Kështu, pas Kuzumbabasë, shkua në Kaninë, tek Muzeu i Pavarësisë, te kompleksi i Sheshit të Flamurit, Vendprehja e Ismail Qemalit, Obelisku i Flamurit, Monumenti i Pavarësisë, vizitua Zvërnecin etj. Aty nga fundi i kohës së qëndrimit në qytet, miku i kënaqur më kërkoi që t'i tregojta shtëpinë më të vjetër në Vlorë. Sigurisht ai mendonte, se përveç përcaktimit, ajo do kishte edhe një pllakë të vogël bronzi në një nga muret e saj që të shënonte afërsisht moshën e saj. Ngrita supet pa ditur t'i jap përgjigje të saktë. Italiani nisi të rendisë arsyet pse përcaktimi i shtëpisë (ose një nga shtëpitë më të vjetra) më të hershme të qytetit historik (por njëkohësisht edhe të çdo qytetit tjetër), ishte i nevojshëm. Pllakat përkujtimore, sipas tij, ishin shenja dëshmuese përjetë të zhvilluar dhe me veprimtari politike, shoqërore, kulturore, fetare të një qyteti a qendre të banuar. Nuk kisha çfarë t'i thosha më shumë mikut dhe i kapur disi ngushtë, me takt ndërrova shinat e bisedës. Sidomos, u befason kur ai tha se historinë një qyteti (edhe shteti-shtova me mendje) e përbëjnë edhe ndërtesat e vjetra, madje me to preket drejtpërdrejtë ajo.

Disa vite pas kësaj, duke u marrë me Fotografinë Shqiptare, kalova nëpër duar edhe shumë foto historike të vendit qysh prej fillimit të shekullit të shkuar. Ndër to, mbresëlënëse janë fotot e festimit të Përvjetorit të parë të Shpalljes së Pavarësisë në Vlorë, ato që pasqyrojnë ardhjen e Qeverisë (Regjencës siç quhej atëherë) të zgjedhur nga

**Për afro 20 vjet kjo ndërtesë funksionoi si Parlamenti i parë Shqiptar. E meriton të paktën një pllakë të vogël bronzi me fjalët: Monument Historik-Mbrohet nga Shteti, ose edhe: Këtu ka zhvilluar punimet Parlamenti i parë shqiptar nga viti 1923 deri në 1939**

Kongresi i Lushnjes (21-31 janar 1920) në Tiranë (shkurt 1920), në kryeqytetin e sapocaktuar, e pak vite më pas foto të parlamentit të ri me disa deputetë, burra hijerëndë, para hyrjes së tij. Këto të fundit të dala nga aparatet e fotografëve të njohur të kohës si Kel dhe Gegë Marubi, Ymer Bali, Shan Pici, Kolë Maca etj. Në pjesën qendrore të fasadës së ndërtesës atëherë shkruhej me germa të mëdha kapitale: "PARLAMENTI".

shtëpi për të ngrehina që shërbeu për Parlamentin Shqiptar deri në vitin 1944. Pas këtij viti ndërtesa ka pasur disa funksione deri sa "gjatë ndërkohës 1996-2000, u kthye në selinë e Këshillit Bashkiak të Tiranës (tek e fundit funksion i përngjashëm dhe i përligjshëm me origjinën). Pas këtij viti aty u vendos Teatri i Kukullave....Më pas "u pëshpërit mjaft për ta kthyer në një Muze të Parlamentarizmit Shqiptar" (siç kanë kthyer në Vlorë prej kohësh

im shumë i merituar i historisë), ish-Parlamenti i asaj kohe (sot Teatri i Kukullave), me sa dimë, mbetet deri tani, selia e institucionit më e vjetër shtetëror shqiptar në vendin tonë. Për këtë, kjo ndërtesë mendoj se duhet të ketë një trajtim të veçantë nga shteti shqiptar, për nderim, por edhe për ta dalluar nga ngrehina të tjera të shumta të Tiranës.

Nuk po kërkohet që të zhvendoset Teatri i Kukullave (ndoshta edhe kjo mund të bëhej), por të paktën t'i njihet ndërtesës me arkitekturë të veçantë merita se dikur ajo ka shërbyer si vendi ku, për herë të parë, vet shqiptarët hodhën themelet e shtetit të tyre modern mbi baza ligjore ndërkombëtare dhe frymë atdhetare.

Gjithashtu, nuk dimë saktë (ndjesë për njohuritë e mangëta) a ndodhet apo jo në Zonën e Mbrojtur arkitektonike të kryeqytetit kjo ndërtesë e vjetër dhe, nëse jo, nuk mendoj se duhet të ketë arsye të forta për këtë.

Në të vërtetë, Selia e Parlamentit të parë, jo vetëm një pllakë përkujtimore nuk ka (nuk bëhet ndonjë hata po të vendoset), por shumë rrallë përmendet në shtyp ose në botime me funksionin e saj zanafillës, atë që i jep vend të mënjanshëm midis shumë ndërtesave të vjetra dhe të reja të Tiranës.

Për mungesën e kësaj pllake, nuk meritojnë lëvdata të gjithë ministrat e kulturës të qeverive shqiptare të

pas vitit 1991. Po ashtu nuk u takojnë dafina nderimi as kryetarëve të Kuvendit të Shqipërisë (pasardhësi i Parlamentit të parë), gjithmonë të viteve pas rrëzimit të diktaturës komuniste. Duke e ulur edhe më poshtë stekën e përgjegjësisë, nuk mund të mos qortohen Drejtorët e Institutit të Monumenteve. Natyrisht dorëjashtë në këtë gjendje të pakëndshme (për mendimin tim) të ndërtesës, nuk janë edhe historianit me grada shkencore e tituj të shumtë nderi. Ndonjëherë edhe mosveprimi në kohën e duhur përbën gabim me pasoja për të ardhmen..

Për pak vite, kjo ndërtesë që për shumë kohë (afro 20 vjet) ka funksionuar si Parlamenti i parë Shqiptar mbush plot një shekull jetë, e ndoshta e meriton, të paktën, një pllakë të vogël bronzi me disa fjalë si p.sh: Monument Historik-Mbrohet nga Shteti ose edhe: Këtu ka zhvilluar punimet Parlamenti i parë shqiptar nga viti 1923 deri në 1939. Ndoshta nga ana ekonomike, vendosja e një pllake prej bronzi nuk besoj se kërkon zhvillimin e ndonjë tendere...Kështu, kujtesës historike të Tiranës, që ndërtimet e reja po e zvogëlojnë me ritme të shpejta, do të vazhdojë t'i mbetet një objekt i rëndësishëm dhe me vlera të padiskutueshme për brezat që do të vijnë. Ruajtja e ndërtesave të vjetra të vendit (që, përgjithësisht, janë jo më të hershme se një shekull e gjysmë), me meritat e tyre, se për hir të së vërtetës janë një numër jo i madh, nuk do të lejojë edhe zmadhimin e mëtejshëm të "Shqipërisë së humbur" (sipas një shprehjeje të Ylli Polovinës).

Pranë dhe rrotull ndërtesës së Teatrit të Kukullave, janë ngritur e do vazhdojnë në të ardhmen të mbijnë ndërtesa me taka të larta, po vlerën dhe hijeshinë e dykatëshes (pavarësisht ngjyimeve me lajle-lule të fasadës së saj) së Parlamentit të parë, vështirë se e arrijnë. Kjo sepse, statusi historik i saj është bio dhe i çimentuar edhe nga afro 100 vite jetë.



Teatri i Kukullave, gusht, 2018


Këshilli Kombëtar (Parlamenti) i zgjedhur nga Kongresi i Lushnjes, "u mblodh në seancën e parë në Tiranë në shtëpinë e Zija bej Toptanit", e cila u shndërrua përkohësisht në selinë e Parlamentit Shqiptar. Më 1925, ky Këshilli i përbërë tashmë nga dy dhoma, Senati dhe Dhoma e Deputetëve, u zhvendos nga kjo

Selinë e Qeverisë së Ismail Qemalit në Muze të Pavarësisë, por jo, madje u "ndërhy duke e dëmtuar godinën e vjetër". (Nga "Gazmend Baku—Tirana e vjetër—Tiranë, 2013").

Pas Ndërtesës së Qeverisë së Ismail Qemalit (mars 1913-janar 1914) në Skelë, ku siç u cek, sot është Muzeu i Pavarësisë (një nder-



# Batakçinjtë fanatikë të pushteteve

NGA **BAJRAM PEÇI**

**J**anë dy parti politike, PD dhe LSI, që prej kohësh kërcënojnë jo vetëm popullatën që s'kanë përkatësinë e partive të tyre, se Shqipërinë do ta mbulojë hija e mynxyrës. Të mbyllur brënda caqeve të botëkuptimit fanatik e ekstremist, këta bij të denjë të sistemit doganor, shkaqet e urrejtjes që do pasojnë luftën (sipas tyre gjithmonë) mbështeten të gjitha në arsyetimin se "...zgjedhjet e bëra para dy vjetësh janë të vjedhura". U duhet shtuar këtyre arsytimit edhe një gjë tjetër që lidhet me kryeministrin: është i korruptuar, është hajdut, është drogmen, është...e kush nuk është!? Nën vështrimin hakërrues të vendimmarrësit Sali Berisha, kryetari i zgjedhur prej tij, pa përfillur institucionet e partisë dhe asnjë këshillë ndërkombëtarësh, nxorri deputetët përfaqësues të PD-së nga parlamenti. Kushti halucinant për të hyrë në zgjedhjet vendore është kryerja e zgjedhjeve parlamentare, pasi Edi Rama të ketë dhënë menjëherë dorëheqjen (!?). Pikë! Armët me të cilat do fillojë luftën deklarohet se janë mosbindja civile dhe bombat me benzinë, që lindën si nevojë kundër makinerisë gjermane në Luftën e Dytë Botërore.

Zgjuarsia dhe budallallëku i bëjnë vizitë si atyre që e meritojnë ashu dhe atyre që nuk e meritojnë. O i fitojmë të gjitha, o i humbim të gjitha!-qënka shprehur Sali Berisha në pragun e vendimmarrjes. Ma do mëndja se Zoti e ka zgjedhur në këtë rast prenë si mostër budallai, sepse mungesa e tolerimit është shprehje e kësaj race që endet mes nesh pa u lodhur. Lufta e Saliut, shkalla e dallisë, si çdo gjë tjetër që ka bërë e bën, duket sikur merr trajtat monumentale të marrëzisë.

Pa tolerancën, frymëzimin për ushtrimin e saj, fanatizmi do ta kish shkretuar tokën me kohë. Edhe nëse nuk do ja kish arritur ta bënte të tillë, e pakta, do t'ua zymtonte jetën njerëve, siç Sali Berisha e Lulzim Basha orvaten të na e bëjnë të gjithë neve që s'jemi në një mendim me ta. E ka provuar këtë si fanatizmi i besimit fetar, ashtu dhe fanatizmi i besimit politik. Fanatikët e njërës palë synojnë të bindin forcërisht tjetrin të mendojë e besojë si ata; fanatikët e palës tjetër udhëhiqen verbërisht drejt qëllimit që i ka vënë vetes për të marrë pushtetin, duke shkelur mbi dinjitetin njerëzor, mbi normat e arsyes e tolerancës. Sokrati, filozofi i lashtësisë është ndër shembujt e parë që sjell historia në filluesën e zhvillimit të fanatizmit e dogmave të besimit. Morali që përcjell dënimi



me vdekje i Sokrati, flet për sjelljen e atyre fanatikëve, që kanë në dorë shpërndarjen e pushtetit dhe të pasurisë, të cilët çdo mendim tjetër ndryshe mbi botën, e shihnin si armiqësor.

Popullata e qytetit tim, Tiranës, ku protestohet prej muajsh e vitesh nga pushtetdashësit, e rrethuar në brendinë gri të mureve e asfaltit dhe ndriçimit verbues të armës "Bombë Molotov", rri e përgjorn në ajrin e vdekur fanatikët e klanit të Berishës e Bashës, se si ata luajnë me nervat e qytetarëve. Luzma fisnore e krahinore që i ndjek, as e kanë njohur dhe nuk e duan lirinë individuale. Ata njohin hierarkinë, strukturën hierarkike, sa të fisit aq dhe të partisë. Të drejtën politike grupi i fanatikëve i gjen në rrënjët konservatore e prapambetja. Këta, partinë e tyre e shohin dhe i përuhlen si me qenë Fe. Ka vetëm një zot-thonë fetë! Ka një autoritet të

përbotshëm që është burimi i çdo të vërtete dhe drejtësie-thotë hierarkia kristiane, ajo islamike, budiste, induse, luteriane, kalviniste, e të tjera shkolla konkurruese! Këto ndarje të dukshme, sëbashku me brenditë e tyre, u shndërruan në faktor social e me rol përcaktues në jetën publike. Po cili është ky Zot? Zoti, për secilin prej tyre është përshkruar në plot libra të shenjtë dhe mendimet (ende të pashtershme) shpesh kalojnë nga debat në luftë për zhdukjen e tjetrit, atij që nuk adhuron Zotin e tij. Ngjashëm u trashëgua edhe në politikë. Për lexuesin, pse ndodh kështu, dua të veçoj dy faktor: sa më i prapambetur një komb aq më shumë terren gjen përdorimi dhe ndikimi i besimit në popull, fetar apo politik qoftë. Pra, troç, fanatikët i pjell injoranca.

Kjo është arsyeja që dikur të gjitha institucionet politike ishin

institucione fetare. Shteti ishte i lidhur ngushtë me fenë, sepse si njëra dhe tjetra nuk e njohin dhe nuk e duan lirinë individuale. Ato, sëbashku, nuk e lënë njeriun e "tyre" të shkëpusë ndërgjegjen. Asgjë mbi to! Për rrjedhojë, as unitet kombëtar. Shihni se sa copë-copë është ky unitet ndër ne shqiptarët, këtu dhe "atje", në krahinën shqiptare të Kosovës, që paketa Ahtisari u mohoi të drejtën etnike, gjuhësore, demografike, ekonomike e atë të formimit psikik.

Kur fillimisht erdhën iluministët, këta "të pa fe" ishin njerëz që luftuan me vepra e ide kundër dogmave të lashtësisë e fanatizmit. Më pas, industrializmi e kapitalizmi në Europë, do të ushtronin një ndikim edhe më të madh mbi mendjen njerëzore. Europa, ku Shqipëria don të shkojë dhe populli në shumicë aspiron të jetë pjesë e saj, për t'u bërë e tillë luftoi të zh-

villohej kundër gjithçkaje që lidhej me fanatizmin dhe të kaluarën. Ata nuk do të kursenin as institucionet fetare, as paragjykimet e fesë. Te kjo kisha e famshme e Notre Damit, që na u dhimbs të gjithve djegja e saj, nuk falej më njeri dhe sa kryeshim mesha. Thjesht ishte objekt i kulturës, i trashëgimisë, i artit gotik dhe shfrytëzohej për të vjelë të ardhura nga vizitorët e turizmi. Instalimi i sekularizmit dhe demokracisë në perëndim, tregojnë se tashmë janë rendi dhe ligjet që administrojnë shtetin e familjen dhe jo fanatizmi. Kjo ishte një ndërmarrje e guximshme, e cila do të shkaktonte një stuhi urrejtjeje dhe zemërimi nga fanatikët hitlerianë, nazistë e fashistë, në gjysmën e shek. XX., shfaqja kjo më tronditëse e fanatikëve që nuk pranojnë palën tjetër. "Tjetri" për këta gangsterë ishte armik që duhej shfarosur.

Sjellja e PD-së ndaj proceseve demokratike në prag zgjedhesh ka marrë trajta maniake. Parvjet ngritën një çadër ku mbiu intoleranca më e habitëshme e këtyre afërsisht 30 vjetëve demokraci. Fuqia me të cilën u mbërthyer pas idesë se, "s'futemi në zgjedhje pa ndarë pushtetin", e bënë këtë parti dhe Bashën të shfaqte paaftësinë komike për të kuptuar ç'po ndodh? Sivjet janë miqtë e tij "opinionistë" të mediave mike, që e kanë qorrollepsur e shtangur me idiotësi e absurditete të pakuqteshme të intolerancës. Njëra prej tyre ka qenë që në krye të herës: ta trëmbin Ramën, se është frikacak dhe do e dorëzojë pushtetin. Këtyre "opinionistëve", që ja kanë parë hairin punës në uzurpimin e studiove televizive, këto ditë ju shtua dhe një shkrimtar. As më shumë dhe as më pak, shkrimtari dhe miku i Berishës i mëshoi idesë se zgjidhja e këtij laku të lidhur fort bëhet duke e frikësuar Ramën. Pra, dhuna dhe jo alternativa, dhuna dhe jo programi do ta sjellin PD-në në pushtet!

Që rendi ligjor të ekzistojë, nuk mjafton të njihet parimi se sundimtarët politikë i nënshtrohen ligjit. Përveç kësaj,

e drejta si një tërësi normash të përcaktuara qartë dhe ndarjet kushtetuese të pushteteve, mbështetin praninë e një sistemi ligjor të detyrueshëm për zbatim. Pikërisht këtë precedent kërkon të krijojë Lulzim Basha e Sali Berisha: jo kushtetuta, jo ligjshmëria, jo ekzistenca e rendit ligjor e mëshiruar në institucione, por marrëveshjet private do jenë ato që do drejtojnë shtetin, afërsisht siç ndodhte në fshatrat nga vishin.

Kërkon t'i ndërrosh mendje fanatikut! Haha...lodhesh kot. Ska lidhje me forcën e fjalës tënde, pa lë më me shkrime si ky, që autori shtyn kohën.

Ndesha këto ditë, duke lexuar "767 letra nga fronti i luftës", mendimin e autorit Damiano Bruno, i cili, për gjendjen e mjerë të Shqipërisë që përshkuan, për vitet 1916-1918, shpreh shpresën se, "...civilizimi në Shqipëri do të sjellë fillimisht pyllëzimin". Mbete pa fjalë nga kjo gjetje, sepse edhe atë pak pyll që patëm, si mall pa zot që ishte, e premë. Ja, thomëni ju, lexues i nderuar, kemi ecur para me këtë karikaturën demokratike apo kemi bërë pas?







# VENDE UNIKE PËR TË VIZITUAR! THE MOST UNIQUE PLACES TO VISIT!



## BUNK'ART 1

- Ekspozita video-muzeale e periudhës së komunizmit në Shqipëri e ndërtuar brenda bunkerit anti-bërthamor të Luftës së Ftohtë

- The video-museum exhibition of Albania's communist era build inside the anti-nuclear bunker of the Cold War



## BUNK'ART 2


- Ekspozita e parë video-muzeale e ndërtuar në kujtim të viktimave të terrorit komunist

- The first video-museum exhibition built in memory of the victims of the communist terror



**Ku ndodhet BUNK'ART 1?**  
Rr. Fadil Deliu  
(afër teleferikut) - Tiranë

**ORARI: 09:00 - 16:00** të hënë & të martë pushim



**Ku ndodhet BUNK'ART 2?**  
Rr. Abdi Toptani  
(përballë Bashkisë) - Tiranë

**ORARI: 09:00 - 18:00** çdo ditë

[www.bunkart.al](http://www.bunkart.al) / [info@bunkart.al](mailto:info@bunkart.al)

**Prenotime / Reservations: +355 (0) 67 20 72 905**

